

LAVDI LEKA


MOS

E

KENDO

ATE

KENGË



**LAVDI LEKA**

# **MOS E KËNDO ATE KËNGË**

**- Tregime -**

BIBLIOTEKA I SHTETIT  
GJERGJ KASTRIT  
3-608+

**1874**

**SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»**

## MOS E KENDO ATË KËNGE

**S**'mbeti njeri pa u habitur, kur u hap lajmi se Nikua do të martohej.

— Do të jetë ndonjë shaka, — thosh dikush.

Po ai që e kishte lexuar vetë ftesën e dasmës përsëriste pareshtur se ishte e vërtetë. Ai do të martohej të nesërmen ditën e djelë. Dhe fjalët, dyshimet, thash'ethemet s'kishin më kuptim.

— Mor, po unë prisja të fejohej me Elin. Të gjithë flisnin për këtë, — e zgjaste muhabetin ndonjë me nge. — Kurse ai! E pabesueshme...

Ata që e dëgjonin tundnin kokën, buzëqeshnin plot kuptim dhe s'ishin në gjendje të jepnin asnjë shpjegim. Se, vërtetë, para disa muajve, për Nikon tregohej një histori tjetër. Thuhej se ai do të fejohej me të bijën e doktorit, me Elin, që ishte studente. Dhe ja, papritur e pakujtuar, ai i mahnitit të gjithë: dërgoi ftesat e martesës, ku si bashkëshorte shënohej Diana Belli, soliste e estradës së qytetit.

U habitën njerëzit, jo se Nikua s'ishte për Dianën (per këtë as që bëhej fjalë), po si ndodhi kështu, fare papritur, kjo martesë për të cilën nuk ishte dhënë asnjë shenjë më parë. Se nuk kish gjë që të mos vihej re në qytetin N. Njerëzit atje ishin në dijeni të të gjitha çështjeve, të të gjitha dashuriçkave dhe zënkave të vogla, që ndodhnin. Ata dinin, se me kë kish folur në mëngjes apo në mbrëmje akcili apo

akila dhe jo të mos merrnin vesh se do martohej avokati me këngëtaren më të mirë. Do kish ndonjë kleçkë në këtë mes. Ose qenë fjalë të kota, ose kushedi... Kushedi si ishin rrrokullisur punët.

Nikua, që e shihte habinë e të tjerëve, qeshej i téri dhe krekohej me të madhe atë mëngjes, ndërsa ndante ftesat. Pse, gjë e vogël ishte? Ai do të martohej me Dianën dhe, veç kësaj, u kish bërë njerëzve një surprizë aq të parpitur, sa që i kish lënë me gojë hapur.

— Si këshfu, mor Niko?

Ai buzëqeshte e tundte dorën.

— Me krushqi e bëre, apo...? — e pyeti një avokat i thyer në moshë.

— Edhe ashtu dhe ashtu — iu përgjegj ai. Një tjetri i tha se e kish marrë me dashuri dhe vetëm disa shokëve të tij ua kish treguar të vërtetën.

## I

Diana Belli ishte një vajzë e qeshur, e shkathët e mjaft e hieshme. Disa këtë hieshi të saj e ngatërronin me fjalën elegancë. Por ky ishte një gabim, një gabim i vogël. Kjo hieshi nuk buronte as nga këpucët e larta me takë të holla, as nga fustanet e prera pas modës; kjo hieshi vihej re në çdo gjest e në çdo fjalë të saj, në mënyrën si ecte, si e dëgjonte tjetrin, si i përgjigjej, apo si buzëqeshte. Në të gjitha këto kish diçka tërheqëse, diçka të bukur që ngjallte admirim.

Flokët i kish töbzës, kurse sytë të kaltërt. Ndoshta për këtë shkak asaj i shkonte çfarëdo

ngjyrë, i shkonte çfarëdo rrobe që vishte e pë  
e priste thjeshtë, por me shijë.

Një mbrëmje, ndërsa ajo po kthehej nga  
estrada e po bëhej gati të hapte portën e ma-  
dhe të shtëpisë, dikush e thirri në emër.

Ktheu kokën dhe u ndesh me vështrimin e  
një të panjohuri. Kështu iu duk në fillim. Por  
kur iu afrua ai dhe i zgjati dorën, ajo mendoi  
se ky duhej të ish avokat Nikua. Me të sikur  
shëmbëllente. Ndoshta dhe gabohej, nuk e njihet  
nga afër; e kish parë shpesh herë trotuareve të  
bulevardit; i kish bërë përshtypje figura e tij  
térheqëse. Dhe vetëm kaq. Më tepër s'ish int-  
resuar për të. Po tashti? Tashti ai qëndronte para  
saj dhe desh ta pyesë për diçka. Ai, e thirri në  
emër, i zgjati dorën. Ajo u ndodh para një të  
papriture. S'dinte si të vepronte. Duhej të tre-  
gohej e sjellshme dhe të priste bisedën e tij, apo  
të largohej pa ja varur fare?

— Çfarë doni? — i tha pa bërë as më  
të voglën lëvizje.

Ai e térhoqi me shpejtësi dorën e mbetur  
pezull, e vështroi vajzën drejt në sy, pastaj ho-  
dhi sytë mbi një gur te këmbët e saj e i tha  
ngadalë:

— Erdha t'ju them se ju dashuroj... Jam ga-  
ti të martohem me ju. Jam avokat Niko...

Dhe heshti.

Ajo buzëqeshi. U bë gati të ikte, pa iu për-  
gjigjur, por fytyra e hieshme që kishte përp-  
ara, sytë plot melankoli e shpresë e ndruan atë  
vendim.

— Qënkeni shumë i guximishëm... — tha  
plot naze. — Mu te dera e shtëpisë? Kjo më  
pëlqen...

— Mund të shkojmë dhe brenda. Unë jam gati t'i them edhe mënës suaj.

— Natën e mirë, avokat Niko! Do të shihemi prapë. — Ajo i zgjati dorën. — Eshtë vonë.

Hapi derën e rëndë dhe e mbylli me ngadalë. Nuk desh të shkaktonte zhurmë; kish frikë mos zhurma prishte hutimin, melankolinë dhe shpresën që lexoi në sytë e avokatit. Se i pëlqeu ai hutim, i dha gjëzim ajo melankoli, ajo shpresë që ndodhej në duart e saj. Që nga pas perdes prej tyli të dhomës së pritjes, ku mbretëronte errësira, ajo e pa atë tek largohej kokëulur, fare ngadalë e pak si i kërrusur. Edhe kjo i pëlqeu pa masë. Ndjeu në vëtvete diçka të pakuptueshme.

— Mos vallë trokiti dashuria në portën time të rëndë?

Qëndroi për një kohë te dritarja dhe u mundua të kujtojë se çfarë i kishte rënë në vesh për avokatin:

«Eshtë djalë i pashëm..» Po këtë e dinte edhe vetë. «Eshtë i zgjuar». Ndoshfa! Po tjetër çfarë? Çfarë dinte ajo? Vetëm kaq? Jo. U mundua të kujtonte diçka. I dukej sikur dikush i kish folur për të. Por çfarë i kish thënë? Ish e pamundur ta kujtonte, ndaj u largua nga dritarja e vrapi te nëna që qepte një përparëse të mbesës. E pyeti atë se ç'kish dëgjuar kohët e fundit për avokat Nikon.

— Ai që ka ardhur dy vjet më parë dhe do të fejohet me vajzën e doktorit?

Diana s'e dëgjoi më t'ëmën.

Po pikërisht për këtë i kishin folur edhe asaj ca muaj më parë; i kishin thënë se ai i kish vënë syrin bijës së mjekut dhe priste të

mbaronte studimet... Atëhere si ishte e mundur që ai?..

Ndjeu se zbulimi që bëri s'i erdhi përmirë. Se, fundja, ai dukej djalë që s'kish të sharrë dhe nuk ishte keq... «Sidoqoftë, si do që të jetë, unë as humba, as fitova», u mundua të ngushëllojë veten Diana. Koha do ta tregojë.

Ajo as që e dinte se Nikua kish dy javë të tëra që mendonte vetëm përmë të e që interesohet përmë jetën e saj; ajo as që e dinte se ky interes i tij filloi në një mbrëmje, ndërsa ajo këndonte në skenën e estradës, e, pikërisht, kur këndonte këngën «**Mos më kujto, kitarë**». Dhe pastaj kur u mbyll skena e ai doli në rrugë, melodia e kësaj kënge e ndoqi kudo. Ditë me radhë s'mund ta harronte këtë melodi dhe bashkë me të edhe sytë e bukur të Dianës, sy që dukeshin sikur qanin e qeshnët njëherësh, sy gazmorë, të shndritshëm e njëkohësisht të mbuluar nga një mjergull e lehtë loti. Diana që buzëqeshte dhe përshëndeste popullin, që thërriste «bis» i qe dukur si diçka e paarritëshme.

Diana nuk i dinte këto hollësi, ndaj psherëtiu lehtë, kur iu kujtua përsëri bija e doktorit, Eli. Po...

— Punë e madhe, — tha dhe u shtri në krevatin pranë drithares; mbylli sytë; desh të flinte, të harronte gjithçka.

Të nesërmen e kërkuan në telefon. Ajo dëgjoi një zë të panjohur, një zë që e pyeste si ishte e ç'kishte ndër mend të bënte atë ditë.

— Kush jeni ju?

Dhe si përgjegje dëgjoi:

— Diana, ju s'm'u përgjegjët mbrëmë.

— Më falni, — i tha ajo, — tani jam e zë—

në. Bisedojmë një herë tjetër, — dhe u larguanga telefoni me një buzëqeshje dhe një pshtetimë gazmore. Parandjeu diçka të këndëshme. Nikua e ndali edhe një herë tjetër në rrugë, por Diana ishte e paepur. E tregonte veten mjaft mospërfillëse. Vetëm pas një javë i tha ftohët:

— Po deshët, bisedoni me tim më. Unë nuk jam kundër.

Ai sa s'fluturoi atë çast. I shtrëngoi dorën fort, fort, kurse ajo vetëm i buzëqeshi. Qerpi-kët e zes që u pulitën në çast e bënë fytyrën e saj më të bukur.

Nëna e Dianës nuk kundërshtoi. Për më te-për, kërkoi që ai të martohej menjëherë, brënda muajit.

Prandaj u habitën të gjithë. S'u besohej njerëzve.

## II

Edhe vetë Nikua pothuajse nuk e besonte të vërtetën. I dukej si èndër. Ishte një èndër me të vërtetë kjo... Diana, te e cila vraponin njerëzit pér të dëgjuar një këngë, ishte gruaja e tij!

Por, pak nga pak, e pikërisht si kaluan dy muajt e parë, ai u mësua me këtë të vërtetë. S'i bënte atë përshtypjen e parë, që ajo ishte gruaja e tij. Gjë që dihej kjo. Dhe, me që dihej, ai nisi të merrej me diçka tjetër. Nisi të shqetësohej se si duhej ta mësonte Dianën, që ta bënte jetën e tyre më të bukur, më të lumtur, që ajo të sillte vetëm gaz e buzëqeshje në shtëpinë e porsangritur.

— Kjo varet nga ti, — i tha Diana.

— Më tepër nga ti, Ani! — (kështu e përkëdhelte ai) — unë jam burrë!

— Po pastaj?

— Po si të them... Dhe shtëpia në duart e tua është... Dhe leku... dhe... — Ai heshti përnjë çast, pastaj shtoi: — sjelljet e mia s'para bien në sy, kurse sjelljet e tua...

Diana ngriti sytë për t'i thënë se e kish kuptuar mirë, po ai vazhdoi.

— Ti e kuption se edhe një fjalë të vetme të dëgjoj për ty, do të më tronditë shumë. Unë e di, ti je e mirë, por ndonjëherë njerëzit flasin, duke u nisur nga disa gjëra të parëndësishëm. Kurse unë... Më kuption? Dua që ti të jesh e paprekur edhe nga fjalët e botës.

— E kuptoj, — tha ajo, duke qeshur. — Po s'ke për të dëgjuar asnje fjalë për Anin tënde!...

Avokati s'e kish zgjatur më muhabetin, veçse, një ditë më vonë, i bëri një vërejtje, ashtu kot, në bisedë e sipër:

— Ani! Ti duhet ta kuptosh vetë. S'është nevoja të ta them unë. Je grua e martuar dhe s'ka lezet të kalosh rrugëvë me burra...

Ajo ndërrroi në fytyrë.

— Unë? Me ç'burra kalova rrugëvë? Je n'ë vete?

— Kur ktheheshe nga puna. Unë të pashë. **Dhe** s'më erdhi hiç mirë.

Diana qeshi me të madhe.

— Po ti e njeh atë; ti e di që ai është Toli, këngëtar i estradës. Dolëm nga puna në një kohë dhe deri te pasticeria ishim bashkë. Si të ndahesha prej tij? Të gjithë e dinë që jemi në një punë.

— Pavarësish. Mua s'më intereson. Në punë bisedo, qesh me të, në rrugë me asnjë njeri mos të shoqërohesh. Pse bëhesh naive? Si s'e kupton që mund të flasin? E kam rrugën këtej, thuaj. Pse, s'mund të gjesh ndonjë shkak? S'ka më tashti, si më parë. Mua s'më pëlqen, dhe mbaroi. S'do rrimë t'u mbushim kokën njerëzve. A po jo?

Ani la hekurin mbi tavolinë, tundi me nervozizëm këmishën, që po hekuroste e nuk foli. Vetëm në mbrëmje i tha:

— Nuk e kuptoj, Niko, kur je kaq i bindur, se unë jam grua që nuk bëj marrëzira, pse u trembesh fjalëve të botës!

Avokatit e'i pëlqeu kjo pyetje e Dianës.

— Pse nuk më dëgjon mua? — i thirri me të madhe. — Kë do dëgjosh tjetër, ahere?

— Po deri dje ty të kam dëgjuar? Pse s'thonë asnjë fjalë? — tha ajo me zemërim. — S'kam pasur ndonjë këshillonjës nga pas, jo.

— Prandaj dhe e ke tundur, — ja ktheu ai me përbuzje. — Që gjashtëmbëdhjetë vjeç...

Diana u skuq dhe u turbullua. Ishte hera e parë që ai i fliste për dashurinë e saj fatkeqe. Iu mbushën sytë me lot, ndërsa Nikua bëri sikur s'pa gjë.

— Nuk e kuptoj, — i tha ngadalë. — Pse s'do të më dëgjosh mua? Kemi për të kaluar një jetë të tërë bashkë dhe, pa qënë, të një mendimi.

Ajo dëgjoi në heshtje.

— Ti e kupton, — vazhdoi ai. — Kam shumë frikë se mos dëgjoj gjësendi për ty. Duaj të të ruaj nga çdo gjë, Ani. Nga çdo fjalë, kupton?

— Të më ruash? Pse?

Nikua s'e vazhdoi më këtë bisedë, por dëshira e tij për ta ruajtur Dianën nga fjalët e botës shtohej dita ditës.

— Dëgjo, Ani, — i thosh ndonjëherë. — Si shumië të kuq ke vënë në buzë. E kupton? S'dua të të mbajnë në gojë.

Dianës nuk i pëlqente të grindej, prandaj kthehej te pasqyra.

— Kush ish ai që përshëndete? — i thosh herë tjetër? — Ç'të duhet ty? Tashti s'ka lezet.

— I kam shokë pune — i thosh ajo.

— Në punë e kë për detyrë: do të flasësh, do të këndosh. Rrugës s'të detyron njeri.

Të tilla muhabete s'kishin mbarim. Diana herë i dëgjonte, herë neveritej, por e përbante veten. Nuk i pëlqenin grindjet dhe ndoshta s'do ishte grindur kurrë, sikur ai të mos e kishte sëmbuar në vendin që i dhimbte më shumë.

### III

Kjo ndodhi menjëherë pas çfaqjes së estradës. Diana e qeshur, e hieshme hyri në bufenë, ku duhej të ishte Nikua. Përherë, kur kishte çfaqje ajo, ai ulej në një stol pranë dritares dhe e priste. Hanin diçka, e, pastaj, niseshin për në shtëpi.

Diana hyri në sallë dhe, që nga dera dalloi se Nikua me dikë bisedonte.

— Ah, Genci, — tha ajo plot nur dhe i zgjati dorën.

— Si ja çoni? i tha ai. — Besoj se i mahnitët njerëzit edhe sot.

Ajo buzëqeshi. Mori gotën e birrës, që sapo

ja mbushën, e ngriti lart dhe u buzëqeshi të dyve. Por, në çast, u zbeh, se ndeshi në vështrimin e ngrysur e të egër të Nikos.

«Ç'të ketë? Mos vallë u tregova shumë e përzémërt?» Ajo tashti duhej të paramendonte të gjitha veprimet që do të bënte, apo fjalët që do të thosh, se pérndryshe...

— Çfarë do hash? — e pyeti Nikua pa ja shqitur sytë.

Diana nuk e dha veten. Nuk i pëlqente që të tjerët të merrnin vesh se i shoqi i saj ishte i pakënaqur nga diçka që as ajo s'e kuptonte.

— E kënduat: «Mos më kujto, kitarë»? — e pyeti Genci. Nikua shtyu pjatat dhe i thirri kamarierit.

Dianës i theri në zemër. Ju duk se i ra tavani mbi kokë.

— A ikim, Niko? Sikur u lodha... — tha ajo e qetë në të dukur.

Te dera e barit i dhanë dorën Gencit. Diana ecte e shqetësuar dhe priste me ankth se ç'do t'i thoshte ai, kurse Nikua i hidhte këmbët i zymtë.

«Ai pa tjetër ma hodhi mua, ma tha me qëllim atë fjalë», — bluante me vete, duke kujtuar lëvdataat e Gencit dhe entusiazmin e tij të papërmajtur për këngën «Mos më kujto, kitarë».

**«Mos më kujto, mos më kujto,  
Se unë fort e dashurova».**

— Sa bukur e këndon Diana! Me gjithë shpirt e këndon, — i kish thënë ai dhe Nikos i kish ngrirë buzëqeshja në fytyrë.

«Çfarë desh të thoshte ai?» kish menduar me vete.

Dhe kur pa Dianën të qeshur dhe të përzémërt, ai u tèrbua më tepër. Në kokë i vërtiteshin dy vargjet e fundit të strofës së dytë

«Po, po. Ai me qëllim ma tha; ai e di që Diana ka dashur një tjetër dhe ma kujtoi me qëllim... Po të tjerët kush e di se ç'flasin. Gjithmonë kështu ndodh. I interesuari i merr vesh në fund. Kurse kjo ma këndon me aq pasion, me aq dëshirë atë këngë! «I mahniti të gjithë» thonë. Ai ma hodhi mua... Kjo dreq dashuriçkë...»

I ktheu sytë plot zemërim nga ajo dhe u vrenjt më tepër.

«E heq veten si ëngjëll; s'e kuption që po më turpëron fare. Ecën e qetë; as që e vret mëndjen...»

— A shkojmë nesër në kinema? — i ndërpren ajo mendimet e dyshirata.

Ai nuk foli.

Ajo tha dhe diçka tjetër, por përsëri nuk mori përgjegje.

«C'të ketë vallë? Të ketë dëgjuar gjësendi? Po çfarë?»

— Ç'ke, Niko?

— ...

— Ünë po të pyes, dëgjon apo jo? Dhe ti duhet të më përgjigjesh. Sikur s'je më ai i pari.

Ai nisi të vërvhellejë. Gjithë rrugës vërvhelleu; pastaj i ngjiti me rrëmbim shkallët e apartamentit dhe, kur u gjend në kuzinë. Ul pranë tavolinës e kërkoi të hante.

— M'i thuaj pak fjalët e këngës «Mos më

kujto, kitarë. — i tha pa i ngritur sytë nga pja-ta me kos.

— Pse?

— M'i thuaj një herë pastaj e merr vesh-  
«psenë».

Diana solli ndër mend të gjitha vargjet e  
këngës dhe u skuq e u inatos pa masë.

Ai ngriti kokën,

— Pse u skuqe?

Asaj iu mbushën sytë.

— Ti gjithmonë do të më dëshpërosh me  
ndonjë budallallék që të shkrep në kokë, — i  
tha ajo dhe u largua.

Nikua u ngrit nga tavolina; e ndoqi deri  
te dera.

«Budallallék... Kështu thotë ajo... Gjithmo-në  
kështu thotë... Por sot...»

Përplasi derën e dhomës dhe iu kërcënua.

— Dëgjo, unë të them mos e këndo atë  
këngë e ti s'duhet ta këndosh!...

— Çfarë?

Diana u kthyte nga ai dhe e vështroi me sy  
të hapur fort fort. Fytyra iu bë dyllë e verdhë.

— Çfarë the, Niko?...

— Mos e këndo atë këngë.

Diana qeshi me të madhe. U zvesh shpejt  
e shpejt dhe ra në shtrat.

Të nesërmen duhej të paraqitej herët në  
punë, se kishin një mbledhje. Ajo veshi trikon,  
mori borsenë e, në çastin që bëhej gati të hapte  
derën, dëgjoi Nikon që i thirri:

— Dëgjon.. mos e këndo më atë këngë.

Ajo u ndal, e vështroi me egërsi.

— As që të pyes fare, — i tha plot gojën-  
dhe zbriti shkallët me rrëmbim.

## IV

Nikua u ul pranë tryezës së punës, nxori dy-tri dosje nga sirtari e diçka nisë të lexojë. Në çast trokiti dera dhe vështronit në prak të saj një njeri të panjohur.

— Ju jeni avokat Nikua?

— Po. Kërkoni mbrojtje? Si është puna? — iu përgjegj Nikua atij mbas pak kohe; pastaj e dëgjoi me vëmëndje djaloshin shpatullgjérë që kërkonte të mës ndahet nga e fejuara e tij. I atij i vajzës dönte ta prishte këtë fejesë, meqenëse djali nuk ishte në gjendje të plotësonte të gjithë kërkesat e tij në lidhje me pajën. Vazza e dönte djalin, por kish frikë nga i ati

— Do t'ju mbroj, — patjetër — i tha Nikua djaloshit. — Hajde në orën një të pregatisim dokumentat.

Dhe, kur u mbyll dera, ai u strukt përsëri mbi dokumentat; por këtë radhë nuk e kish mëndjen në vend. I doli parasysh fytyrë e zëmëruar e Dianës, sytë plot lot që shkëlqenin me një bukuri të paparë deri atëhere, që shkëlqenin e vështronin plot qortim, ndërsa buza e vogël e lyer me të kuq dridhej plot nervozizem.

«As që të pyes fare!» i kishi thënë Djanaë dhe kish ikuar.

Pastaj ish përplasur dera me forcë. Ishini dëgjuar disa trokëllimë nëu shkallë, trokëllima të shpejta.

«As që të pyes fare!» Kjo ishte e tmerrshme; e pabesuëshme. Dhe përfajtë kujt? Fundja, ai is'kërkoi ndonjë gjë itë madhe. Të gjithë burrat i mësojnë gratë me c'është mirë e

ç'është keq. E ç'bëri ai më tepër? Ajo është grua e martuar. Mirë do të ishte sikur mos ta këndonte atë këngë. Kushedi ç'thoshin njerëzit kur e dëgjonin.

Dhe vetëm kur filluan gjyqet, takimet me njerëz të ndryshëm, ai sikur e ndjeu veten më të lehtësuar. Brenga që po i grryente shpirtin; sikur po flinte thellë thellë dhe vetëm ndonjëherë, ashtu përgjumësh, ngrinte kryet e binte përsëri.

Kur u kthye në shtëpi tavolinën e gjeti të shtruar dhe Dianën duke preqatitur diçka pranë furnellës elektrike.

— Mirë dita, — foli ai pa e vështruar.

Dhe mori një përgjegje që erdhi si pëshpëritje.

Bukën e hëngrën në heshtje. Pastaj, si pastroi tryezën, ajo i tha se do të shkonte nga e ëma. Dhe Nikua mbeti midis katër mureve. Mërzia u ul pranë tij. Ajo iu bë ferrë gjithë ditën dhe gjithë natën.

## V

Të nesërmen salsa e teatrit u mbush plot. Njerëzit mbanin në duar disa letra të bardha. Siç duket, ishin programet. Mjaft prej tyre bisodonin po s'merresh vesh gjë.

Në castin kur u shuan dritat hyri edhe Nikua. Zuri të vetmen karrigë, që kishte mbetur bosh dhe hodhi sytë në skenë. Dikush po jepte programin, diçka thosh, por Nikua s'e dëgjoi. I tërroqi vemendjen nië bisedë pranë tij.

— Eshtë, pra, Diana në program, — për-

sériste njëri. — Ja ku e ke. Diana Belli këndon...

— He, po, po qenka...

— Por...

Muhabeti u ndërpren. Në skenë dolën dy grante veshura si kameriere e diçka po thoshin. Publiku u gajas, kurse Nikua s'e kuptonte se ç'kish aty për të qeshur.

Sa herë që delte spikeri atij i dridhej zemra. Tamam si ato ditë kur vinte në çdo numër të estradës për të dëgjuar zërin e saj, melodinë e bukur: «**Mos më kujto, kitarë**». Por atë natë nuk donte ta dëgjonte atë këngë, ndaj tronditej aq shumë; s'donte ta dëgjonte. Kjo ishte rruga më e mirë për pajtim. Fundja pse të ngulte këmbë ajo?

Diana doli, e bukur, e qeshur, si përherë, veçse sytë e saj ishin të trishtuar.

Salla buçiti nga duartrokitjet. Ajo buzëqeshi. Pastaj u dëgjuan disa tinguj, një melodi e ëmbël dhe zëri i saj kumboi.

— Bravo, bis! — thërriti salla.

Diana buzëqeshi me çiltërsi, falënderoi. Përsëri u dëgjuan disa tinguj, pastaj një melodi gazmore dhe zëri i Dianës plot zjarr. Kur heshtë ajo, përsëri duartrokitje, përsëri bis, përsëri admirim.

Spikeri doli për të katërtën herë që të vazhdonte programin, por në sallë s'gjeti vend heshtja.

— «**Mos më kujto, kitarë**» — cirrej di-kush.

— Kitarën, kitarën... Të na këndoje me kitarë — thërrisin të tjerët. Disa u ngriten më këmbë. Atëhere Diana doli si e ndrojtur, buzë

qeshi, përshtëndeti, falënderoi e deshi të larë gohej.

— Mos më kujto, kitarë...

— Pushoni — tha dikush aty pranë — mund ta këndoje më vonë.

— Jo, jo... S'është në program — u hodh burri pranë Nikos. Kurse ky i fundit sikur u hutua. Herë shihte Dianën që rrinte e ndrojtur në skenë, që rrinte si e mundur, sikur kërkonte ndihmë për t'u mbrojtur nga kërkesat këmbëngulëse të publikut, herë shihte sallën që gjë monte.

Dhe ndjeu prapë zbrazësi në vetvete. Ajo përshtëndeti për të katërtën herë dhe befas, sikur të ishte kujtuar për diçka, kërkoi kitarën, sec i tha orkestrës e qëndroi pranë mikrofonit.

U shpërndanë disa tinguj, një melodi e lehta dhe e zgjatur, pastaj u shqyptuan ngadalë, si një psherëtimë, fjalët e para të këngës. Sytë e qeshur u mbushën me lot, ndërsa vështrimi i tyre u mbërthyte diku mbi kokat e publikut.

«Mos...»

Përsëri fjala doli si një psherëtimë dhe Nika ndjeu një sëmbim në kraharor. Nuk dontë t'i shihte ata sy të dashur nën mjegullën e lotve e priti që ata të qeshnin, të shkëlqenin si mbrëmjeve, kur ai e dëgjonte me èndje këtë këngë.

Kur thirrën të gjithë «bravo», ai buzëqeshi e i përplasi shuplakat më tepër se kushdo. Doli ngadalë, tamam ashtu si kishte hyrë, si një hajdut i shkathët, dhe priti në koridor. —

—  
—  
—

## ZANA

### 1

Laboratori ndodhet larg. Me autobuz duhen pesëmbëdhjetë minuta për të shkuar gjer atje, po Zana as që e ndjen këtë largësi. E ulur në kolktukun e autobuzit, e tretur në mendime, ajo thotë përherë me vete: «Sa i shpejt që mbërritëm!», kur dëgjon shoqet që e thërrasin të zgresë. Në ato çaste dëshëron që rruga të jetë e gjatë, e gjatë, dhe ajo të mos i ndërpresë mendimet.

Edhe këtë radhë s'e ndjeu largësinë. Hyri brenda kokëultur. Tashti as që i bënte përshtypje era e fortë e acideve; që përzihej me atë të parfumeve...

Ditën e parë ajo kujtoi se nuk do të mbushte as javën në këtë laborator. Po njeriu u mësuash ka me çdo gjë...

Reparti i saj ndodhet lart, në katin e dytë;

Ajo ngjiti shkallët menjadalë, u matëtë hapte derën, e në çast u ngrys. Dikush i tha se e kërkonin në drejtori...

Hyri aty e mvrejitur, as mirëmëngjesi nuk tha...

— Më kérkuat?

— Po. Sot do atë punosh! pasditej...  
shtrë pri-shur një maqinë.

I hypi gjaku në kokë...

«E gjetën këto. Tamam sot... Sikur m'a bëjnë pér inat». — mendoi me vete.

— Ç'farë?... Pasdite?... Jo, nuk punoj. Kam një punë. S'mundem.

Pasdite do të takohej me Petritin. Fytyra ju ndez. Sytë i shkëlqyen ftohtë, mospërfillës.

«Pasdite!... Dinë këta!...»

Drejtoresha s'e përbajti dot veten, shtrëngoi dorën te karriga dhe i thirri me zë të ashë pér sa që u dëgjua jashtë. Zana u zverdh në fytyrë.

— Ikë! — përsëriti drejtoresha. — Ikë! Dëgjon?...

Zana iu afrua ngadalë derës, e tërroqi ma forcë e ajo u mbyll me tërsellëm.

— Pasdite, thotë!... Le të punojë vetë pasdite!

Dy punëtore aty pranë panë njëra tjetrën; pastaj vështrimi i tyre ndoqi Zanën në koridorin e ngushtë.

— Si dukej në fillim, si ëngjëll, — tha njëra. Tjetra vetëm tundi kokën.

E egërsuar, Zana hapi derën e repartit, ku punonte.

— Pse më ke zënë maqinën? — iu vërsul ajo Ritës. — Ty të është thyer, ti të puaosh pasdite. Do t'ua hedhë të tjerëve, kjo.

— Çfarë?...

Ritës i hypi gjaku në kokë. U ngrit nga vendi, ju afrua Zanës, po e përbajti veten.

— S'ke turp? — Bukua u inatos më tepër se Rita. — Turp të kesh, Zana!

— Shih, mbylle gojën, se ta përplasa me ampule kokës...

— Aq ta pret ty...

— Zana, ti s'je e vogël! — Kerkoi ta merrte  
me të mirë Liza. — Pse të të mësojmë ne?.. Tij e  
më e ngeshme nga të gjitha këtu... Pastaj, e di  
që Rita çdo pasdite shkon te i shoqi në spital?...

— Punoni vetë atëhere dhe...

C'ti thoshin më?... Gdhëndet trungu?... Bu-  
kua la punën, veshi pallton dhe ja lë maqinën  
e saj Zanës, megjithëse për pasdite kish marrë  
një numër për t'u vizituar të mjeku.

Zana s'e hapi gojën asnjë herë.

«Ajo dihet. Nuk më duan, nuk më duan.  
Më kanë inat se vishem mirë, se jam  
e bukur, dhe ua kaloj të gjithave. Pse s'më  
lenë rehat, ç'duan nga unë?... si e si të gjejnë  
shkak... Jo s'janë stampuar mirë, jo s'lexohen,  
jo ke thyer. Si s'u mërziten!...»

Ndaj Zana, sa herë që fillonin t'i bënin ndo-  
një vërejtje mbyllte veshët dhe e vështronë drejt  
në sy atë që i fliste: «Mbarove, si thua?...» — i  
thosh. Nuk shoqërohej me asnjë vajzë nga tjet-  
parti. Lenka, shoqja e saj, kish tri javë që ishte  
larguar nga laboratori. Ajo ishte fejuar me  
një djalë, që do të nisej së shpejti jashtë shtë-  
tit me punë. U fejua aqë shpejt e papandehur,  
sa që i çuditit të gjithë. — Po, ti s'e njeh fare, — i tha Zana, kur  
mori vesh. — Asqë më kishë thënë gjë muaj.  
— Budallaqe!.. E c'rëndësi ka që ta njoh?..  
E di ku do të shkoj me të?...

— Po, do të kalosh jetë!

— Të gjithë e lavdërojnë, thonë goxha dja-  
lë. E pse të jetë i keq?... Punë e madhe që s'e  
njoha. E kur ta njihja? Ne përenjë muaj do të  
misemi...

“Zana s'kish folur, pastaj nuk e kish takuar

më Lenkën. Një ditë e kish parë nga larg, që ecte për krah një burri zeshkantë hollë që të gjatë, që i hidhë hapat aq shpejt, sa që Lenkës i duhej të nxitonë. Kish hyrë në pasticeri dhe i kish ndjekur me sy gjersa ishin zhdukur, në rrugën e Dibrës.

Në repart menduan se ikja e Lenkës do të ndikonte për mirë te Zana, por për çudi sikur ndodhi e kundërtë. Ajo tashti s'e bënte qejfin qeder fare. Dhe në i flisnin; dhe në e këshillonin, ajo do t'u përgjigjej:

— Ç'të bëjmë, të ditur s'kemi lindur... Njerëz jemi dhe do gabojmë... Në rast se dikush i thosha se pse e kish harruar maqinën pa pastruar, ajo ja kthente fët e fët.

— Njeri jam, mund të harroj... Dhe heshte.

Vajzat vështronin njëra tjetrën dhe ja hidhënin gjithë fajin mbrëmjes që ish organizuar një të shtunë në pallatin «Ali Kelmendi», përrininë punëtore të kryeqytetit. Por po ta pyesje Zanën për atë mbrëmje, tjetër do të dëgjoje. Endërsa do të shqiptonte: «E mrekullueshme, mbrëmje si ajo s'kam parë»; një buzëqeshje e mbëbël do t'i hijeshonte fytyrën. Sytë do t'i xixëllonin, se Zana ndillte kujtimet më të ëmbla për atë mbrëmje...

... Po e cte ngadalë e me kujdes në rrugicën me kalldrëm, kokëlur, sikur numëronte gurët.

Aty te rrugica mendimet iu ndërprenë. I doli përpara Lenka, e qeshur, e freskët.

— Qënke bërë si... si... ajo artistja... ja harrrova emrin... i tha ajo. — E sheh çështë të vëshurit?... Po ti s'më dëgjon mua. Njerëzit përt'u veshur, përt'u zbuluar, nuk kursejné, kurse ti... Nuk e kuptoj, c'mendon gjithë kohën. S'e marr dot me mënd. Kurse unë gjithë pese mbëdhjetëditéshin, bëj plane se c'do të blej kurtë marr rrogën, si do ta pres fustanin e ri, kur do ta vesh...

Një grup vajzash u doli përpara.

— Zana!... — thirrën ato si të habitura. — Për zotin, s'të njohëm fare! Shiko sa bukur të rri fustani!...

Zana nuk foli. I erdhi shumë inat se vajzat buzëqeshnin njera me jatrën dhe shihnin flokkët e saj bërë bobë. Ajo u ngrys, mori Lenkën përdore e u nis përpara.

Ngjitën me rrëmbim shkallët e pallatit «Ali Kelmendi»; hynë me ngurrim në sallën e madhe. Ciftet rrëshqitnir nën tingujt e valosit. Të dy vajzat zunë vënd afér dritares; vështruan përrreth; u buzëqeshën të njohurve. Një i kuq i lehtë i mbuloi fytyrén Zanës, kur vuri re që po e vështronin. Disa, bile, zgjatën kokën. Ajo u bë në qejf. Zemra i gufoi prej gëzimit.

Vals... vals... vals... — këndoi nëpër dhëmbë. I hypi një dëshirë që të ngrihej, të fluturonte nën tingujt e bukur, — të thërriste, të këndonte... Zemra i rrahu fort. As, vetë, s'ë dinte pse; pastaj kapi Lenkën përdore, — op...

— Sa mirë! — i tha ngadalë.  
Sytë plot gaz ndiqnin ciftet, që rrëtullohen, pa mbarim.

— Lena, e di?...

Nuk e mbaroi fjalën. Një djalë i ri e fttoi të kërcente. Ajo vështroi nga shoqja si mendrojtje, pastaj u ngrit, rregulloi fustanin; i dha dorën djałoshit. Ai e tërhoqi lehtë. Filluan të rrrotullohen në sallën e madhe. Këmbët e bukura rrëshqitën mbi çimento. Fustani i kaltërt ë hap.

I ranë sallës rreth e qark.

— Ju pëlqen? — dëgjoi ajo zérin e djaloshit.

S'u përgjegj menjëherë. Ngriti sytë, po uli shpejt. S'mundi t'i përmbahej vështrimit të tij... Ai e vështroi... E vështroi si... as ajo vetë nuk dinte ta spjegonte.

— Po! Shumë bukur është!...

— Studente jeni?

— Jo!

Ngriti sytë dhe po me atë shpejtësi i uli prapë.

— Jam laborante!

Përsëri ajo buzëqeshje e ëmbël në fytyrë.

— Ju? E pamundur!

Ai kish një zë të çuditshëm, ledhatonjës e mjaff të ëmbël.

Zana vështronte përpara. Megjithatë, e ndjente vështrimin e tij, vështrimin e dy syve të zes si në kafe.

— Në fillim, mendova mos jeni ndonjë bëlerinë e re, pastaj studente. Sa për laborante, as që më shkoi mëndja!

Zana qeshi. Fytyra iu bë më e bukur. Dhëmbët e bardhë e të vegjel i shkëlqyen.

— Po, laborante — shqiptoi ajo ngadale.

— Aq më mirë. Do të kem rastin të shkruaj pér ju. Kjo më gëzon pa masë. Si ju quajnë?

— Suzanë.

Muzika vazhdonte. Çiftet rrrotulloheshin.

— Tamam sikundër jeni, Zanë.

Ai e vështroi më bisht të syrit.

— Mua më quajnë Petrit. Jam gazetar.

Ajo nuk foli. Në sytë e saj lodroi një buzëqeshje mahnitëse.

— Apo s'ju intereson?

Përsëri heshtje.

Pastaj ajo ngriti kokën dhe e shikoi atë pa frikë, drejt në sy.

Valsi imbaroi. Filluan tangot, fokstrotet. Petriti një e dy dhe e ftonte atë të vallëzonte. Zanna s'i numëroi dot sa herë kërceu ma të... tjetra.

Në orën njëmbëdhjetë, ajo bashkë me Lenën u ngritën. Petriti u propozoi t'i përcjellë. Ajo s'pranoi. U nisën bashkë me disa shoqe të tjera.

Kur ra në dyshek, s'e zinte gjumi!

Vals... vals... vals...

I dukej sikur dhoma buciste nga melodiat e orkestrës

«Si ju quajnë?»

«Laborante? E pa munduri...»

Pastaj dy sy, dy sy të zas si në kafe, të bëkur, që shndrishin...

«Do të shihemi, besoj!...»

Dy sytë prishin përgjegje! Pastaj si buzëgshi; buzëgshi vëtëm nga një «po», nga një belbëzin i Zanës.

Vals... vals... vals...

Dikur e këndonte më shoqet këtë mëlodji...

Tə nesērmen atē e zgjoi zéri i egērsuar i xhajës. Aş se kujt i gérthiste nə koridorin e gjerë, afər dhoməst kū flintə ajo.

— Si duket, akoma s'i kanë ikur xhindet, — tha ajo.

Para se tətē nisej pér nə mbrémje, ajo i zemeroi që tə gjithë pérveç Dités dhe Lulit tə vər gəl. Një shoqe i kish shitur një fustan tə bükur, ardhus nga jashtë. Kur dëgjoi Muçua çimin min iu ngritën nervat pérpjət e ç'nuk i foli Zanës. Ajo aq deshi e i tha se punon e i nxjer me djersën e saj lekët, ndaj do blente ç'tə donte, i tha se andej e tutje do tə ipse lekë vetəm sa pér ushqim. As që ju trembsyri, kur iu afra xhaja ta godiste. Pérplasi derën e pas pak u nis pér nə mbrémje.

Me sa dukej, xhaja akoma s'e kish harruar inatin e një dite më parë.

U kthyə nga ana tjetər; i mbylli përséri sytë, por gjumi ish larguar; veshi me përtim füstanin bojë hiri, që ish varur nə gozhdë; rregulloi krevatin dhe doli nə oborr. Lija, nusja e xhajës, ishte duke larë rrobe. Bëri sikur nuk e pa Zanën. Luli shtatëvjeçar buzëqeshi e vrapoi pas pulave me një kallam nə dorë.

Zana, ulur te guri i madh afər derəs, ndor qı me sy lëvizjet e tija.

Para tremuajve, kur la shkollen ajo, se s'kish qejf tə mësonte mendoi se edhejeta e saj do tə ndryshonte, ajo s'do ishte më një vajzë e vogël me përparëse tə zezë, do tə punonte dhe njerëzit do ta shikonin ndryshe. Ajo s'do

bezdiste më njeri përkëpucë, as përcorape... Por... S'ndodhi ashtu, Pesëmbëdhjetëditshet kallonin njeri pas tjetrit, dhe xhaja as që e vriste mëndjen për Zanën.

Dhe gjithçka për të shkonte si më parë, ashtu siç pat qenë. Kurse ajo budallaqja shpresonte e priste që çdo gjë të ndryshonte vetë, dhe ndoshta do të kish pritur për një kohë të gjatë, po të mos kish qenë zënka për shkak të fustanit.

#### 4.

Ditë të tëra ajo ishte e dërmuar.

Si do të vente halli i saj? Si do të rrrokulli-seshin punët? T'i përulej xhajës, t'i kërkonte të falur e të vazhdonte të ecte ashtu me hapin e zakonshëm në jetë, apo mos ta pyeste fare?

Ajo lëvizte duart para maqinës; i lëvizte pa ndërprerje, me shpejtësi. Në kokë mendimtar i luanin valle. Mendime të ndryshme, të parngjajshme me njeri tjetrin, kurse maqina s'pushonte. Ajo këndonte një këngë me zërin e saj monoton, dhe nuk mërzitej.

Po ajo ishte maqinë, kurse Zana ishte njeri... Nuk i pëlgente monotonia...

Shikonte shoqet me bisht të syrit. I vinte turp. Ato ishin të gëzuara. Vetëm ajo ngrysej e pikëlllohej. Dhe kjo zgjati ditë me radhë. Sidomos kur mori rrrogën e parë pas grindjes që kish ndodhur, në shtëpi, ajo u turbullua shumë dhe, duke shtyrë portën e madhe të oborrit hyri kokëllur në sallon. S'dinte ku të shkonte e cfarë të bënte.

Në kuzinë ishte gjyshja me xhajën dhe Lijen. Ata ishin ulur larg njëri tjetrit dhe rrinint të hieshtur. As që ja kthyen përshtendetjen Zanës. Kjo u ul pranë dritares, u përtyp ngadalë dhe vështroi në oborr.

— Ule perden, ç'më rri aty! — i tha xhaja hierëndë.

Zana u bind. Shkoi pranë sepetit, po e ndjeu veten më të këputur. Perdja e ulur sikur u tall me të dhe iu duk sikur dikush i thërriste e queshtë:

— Si më parë, si më parë, si më parë. Çdo gjë si më parë... Si perdja e varur...

Sikur të kishe njëzet vjet pa shkuar në këtë shtëpi dhe ta vizitoje sërish, nuk do të gjeje ndonjë ndryshim. Vërtet që kolltukët ishin vjetëruar e mobiljet e dhomës së pritjes kishin marrë një ngjyrë tjetër, po nuk është fjala këtu. Në shtëpi asgjë s'ishte pakësuar dhe as ishte shtuar. Përveç kolltukëve, në dhomën e pritjes gjëndej një trapezë rrumbullake me një vazo të kristallë, një bufe dhe një pasqyrë tualeti te cepi i dhomës, karshi derës. Në mur ishin varur ca korniza të vjetër uara.

Kjo dhomë rrinte mbyllur dhe hapej vetëm kur vinin miq, u përkiste të tjerëve. Dhomat e tjerë ishin pothuajse të gjitha një lloj: me ndonjë krevat prej dërrase te cepi dhe shiltera të shtruara në dysheme. Në kuzinë të zinte syri një sofër varur të muri, një dollap të vogël, disa karriga të prishura dhe një minder.

Edhe para qirimit, kur Beqirajt cilësohet shin si tregëtarë, këto dhoma ishin po kështu: të mëdha dhe të zbrazëta.

Të mëdhenj e të vegjel hanin të gjithë në një pjatë, të ulur rrëth sofrës; jashtë e hiqnin veten si

njerëz që dinë se g'është bota, prandaj, para se të fillonin ngrënien lëshonin perdet e dritares dhe mbyllnin derën me çelës. Dhe të gjitha këto atyre u dukeshin gjëra të zakonshme.

Por shtëpia dykatëshe, aty në rrugicën e vogël me kalldrëm, kish filluar të dukej ndryshe në së të e njerëzve. Muçua, xhaxhaj i Zanës, vetë e kish vënë re këtë qdo ditë dhe mallkonte pallatet e mëdha, që ishin ngritur rrëth saj.

— Sa e lëvduan këtë shtëpi një herë, — murmuriste ai, — ç'nuk thanë përtë kur u ndërtua!... Kush s'na e pati zili? — Tani ikën të gjitha... Fluturuan...

Beqirajt ishin prej Tirane, bile gjyshja Tixhe, përveç Tiranës, s'kish parë qytet tjetër mes. Gjatë gjithë jetës së tyre kishin shitur pemë. Në vitin 1936 arritën të bëhen nga pemëshitesit më të dëgjuar. Atëherë kishin një dyqan të madh në rrugën e Dibrës, ku shërbën katër shites. Të ardhurat ishin të mira. Pak nga pak, në dyqan filloj të shitet vëre, raki, bile, në kohën e Italisë, edhe vaj e uthuill. Pikërisht në atë kohë, vëllai tjetër i Muços, babai i Zanës, që ishte kryetar i familjes dhe pesë vjeç më i madh se Muçua dhe që e kishte gjithë dyqanin në dore, u bashkua me xhaxhanë dhe të dy ngritën edhe një bulmetore. Tixhja ishte përzier në të gjitha këto pünë dhe kish ndihmuar sa kish thundur.

Fitimet u ishin shtuar mjaft. Ata ndërtuan shtëpi dykatëshe, grumbulluan mjaft pare, që i kthyen në sende me vlerë. Por, në atë kohë, e plakosi familjen një fatkeqësi. Babai i Zanës u vra nga një aksident automobili, duke lënë të shoqen gjashtë muaj me barri. Kur u bë Zana tre vjeçë, i vdiq edhe e ema dhë ajo mbeti si e

huaj në shtëpi. U rrjit neri kujdesin e Tixhes Muçua e përvetësoi gjithë pasurinë e Beqirajve dhe u tregua mjaft i zoti për të rjepur të tjetër e për të fituar. Vetëm një frikë e ndiqte nga pas: kolektivat. Atij sikur i buçisnin veshët nga kjo fjalë. I dukej sikur gjithë Tirana ishte mbushur me kolektiva.

— Hyri edhe Qerimi në kolektivë — tha me një zë të çjerrë dhe këto fjalë ranë si bombë për plakën dhe të shoqen, kurse Zanën sikur e lehtësuan nga diçka e rëndë. Kjo la pjatën në grumbullin e enëve të palara, mori një libër dhe u ul në cep të minderit.

A do t'i thosh vallë Muçua si përherë: «E more rrögën, Zanush?» Sidoqoftë, ajo s'duhej të rrëmbehej.

Shkronjat e librit sikur vraponin, thyhet shin, lëviznin, rrrotulloheshin dhe fjalët nuk lidheshin. Ata të tre heshtnin.

Sa minuta kishin kaluar kështu? As ajo s'ë dinte... Kështu, në këtë heshtje të tmershme, që dhe lëvizja më e vogël të bën të dridhesh, Zana zgjati dorën te rjeta. Iu duk sikur e përgjønin gjashtë sy. Zgjidhi shaminë, nxori dy pëseqindëshe dhe iu kthye xhajës:

— Na, — i tha.

Ai nuk e zgjati dorën si përherë. E vështroi rreptë: Zana i lëshoi lekët pranë tij mbi minder dhe doli nga kuzina. Fryma thuajse i mbeti fare. U mbështet te muri i koridorit e mbylli sytë. E ndjeu veten të lodhar, të drobitur. Vuri veshin të dëgjojë gjësendi, po në kuzinë mbretëronte qetësia e mëparëshme. Vuri syrin te vendi i çelësit. Zemra i trahu fort. Muçua kish zgjatur

dorën tē merrte paret. Jō, nuk i grisi, po i futi  
në xhep dhe u ngrit.

Zaħa hyri nē dhomēn e saj. Ċdo tē bēnte ai? Ajo priti; priti tē hapej dera; priti t'i berti snin, ta rrihnin. Por hapat e Muċċas sikur u larguan. Dera e oborrit u pērplas. Zaħa u ċlirua nga zin-xhiręt, u hodh mbi krevatin prej dērrase, pastaj-kérceu nē dysheme, u vesh me rrēmbim dhe, gjysmē ore mē vonē trokki nē deren e Lenēs, nē apartamentin numér 81.

### 5.

Kush mund ta njihte Zanēn pas kēsaj? Ajo ġeli e lulęzoi papritur. Njerēzia kthenin kokēn, kurse ajo shkonte drejt, vēshtron te pērpara dhe ka-lonte nē rrugę me njē tē ecur tē shpejtē. Duart nuk i lēvizte fare, hapat i bēnte tē voċċela, me-gjithatē, fundi i għerġi, i kuq, me kopsa għier nē fund, i rrotullohej sa andej-kēndej.

Pērherē ecte kēshtu, ngadalē, nē trotuarin e bulevardit, e ndrydhur nē vetvete. Nuk yēsh-tronte asnjē njeri. Edhe nē rast se dallonte qē nga larg ndonjē shoqe tē saj, bēnte sikur s'e shiħte.

Kush rri tē flasē pēr budallallęqe... Si je, si ja con... Kur s'ke c'te thuash, pse tē flasēsh? Se mos kish kohē ajo! Nē kokē i zjenin gjithé ato gjéra, gjithé ato plane. As vetē s'e dinte c'te bēnte mnej paré. Ja, i duhej njē zhupón, njē palē kē-pucē.

Si kthehej nga puna, hante bukē shpejt e shpejt, pastaj fillonte tē rregullohej para pas-qyręs. Vishej dhe, si ngħesht ħixx-pi e għejre pas-

belit, buzëqeshë me vete dhe ndjente kënaqësi, se i kujtohesin fjalët e Petritit: «Ke një të që shur, që s'e ka kush! Kushedi sa veta ke marrë në qafë me këtë të qeshur... Po shiko, mos i buzëqesh tjetër njeriu...». Dhe ajo gajasej më tepër, gajasej e lumtur.

Që nga mbrëmja e pallatit «Ali Kelmendi», qdo ditë e shikonte Petritin në bulevard dhe i buzëqeshëtët, siç bënte edhe ai, Pastaj, plotëtë e ndëra, merrte rrugën e shtëpisë. Kështu, edhe një të shtunë, ajo po kthehej kokëulur, me kujtimet e bulevardit. Donte të sillte ndër mend sa herë e kish parë, sa herë i kish buzëqeshur, po nuk i kujtohej. Te çepi i rrugës dikush e thirri. Ktheu kokën e trembur, po edhe me një dyshim që i gjëzonë zemrën. U drodh kur pa aty pranë saj Petritin, Nuk i tha asgjë; i dha vetëm dorën. Ai ja shtrëngoi fort dhe i buzëqeshi.

— Hajde të shkojmë, — i tregoi një rrugicë të ngushtë. Ajo heshti. Pastaj i tha se e prisnin në shtëpi.

— Të të përcjell atëhëre?...

— Mirë...

Pothuaj gjithë rrugën e kaluan pa folur, pastaj, i shtrënguan dorën njëri tjetrit. Shkuani në drejtime të ndryshme. Petriti e ndali edhe një herë tjetër. Pikërisht në atë vend, Zana qëndroi, përsëri bisedoi dhe vazhdoi rrugën bashkë me të, e lumtur sa s'tregohet. Pastaj, një ditë, ndërsa ajo po ecte kokëulur drejt autobuzit, dëgjoi që e thirri dikush.

Ajo ngadalësoi hapin.

— Çfarë do, Petrit?...

Djali nuk u përgjegj, po vështrimin s'ë hoqi prej saj. E kështu kaluan pesë-gjashtë sekonda.

— Takohemi pastaj? Si thua? —

— Jo. — shqiptoi ajo ngadalë, po shpejt u pendua për fjalët që tha. — Kam mbledhje tash-ti, në orën katër, — nxitoi të ndreqte gabiminat.

— Pas mbledhjes Gjer në ora shtatë, ju dë të keni mbaruar. Të près në parkun «Riniak».

Ajo heshti. S'dinte ç'të thoshte. I buzëqeshi atij, i dha dorën e vrapi të arrinte autobuzin.

Kështu filluan ditët e dashurisë, ditët e takimeve, të pëshpëritjeve të embla, ditët e ëndravë vashërore.

— Ku shkon? U bëne haram. — gérthiste xhaja.

— Kam mbledhje... Kam eskursion... Kam... — e gënjente gjithnjë Zana.

— Do të vij të pres aty, dëgjon? S'ëbuka turpëruar njeri Muço Beqirajni deri tashti, prandaj dhe ty s'të lë.

— Po pse? Cfarë po bëj unë? — hidhëj ajo.

— Mirë, nuk shkoj, po do të përgjigjesh ti. Pastaj Muçua heshtëte. Dhë Zana vazhdonte rrugët e saj, takimet me Petritin.

Petriti sapo kish mbaruar studimet e larta. Prindërit i kish ngë Shkodra, po banonin në Tiranë. Dikur ai ëndërointe të bëhej gazetar i dëgjuar, t'i mahniste njërezit me shkrimet e tij, si ata gazetarët që përmëndeshin nëpër romane. Në ato çaste atij s'i pëlqente fare vëtmia. Bota e fantazisë ishte e bukur. Atij nuk i vinte mirë të shkëputej prej saj. Buzëqeshite i lumtur Zanën, që me vështrimin e parë, e bëri për vete. E pse, vetëm Zanën? Po kur do të përfundoate vallë?

Në mbrëmjet e freskëta të vjeshtës, kur Zanë

na ë largonte, ai ndalej i zemëruar. Sytë e tij të gëzueshëm errësoheshin.

— Ti s'më do, jo, s'më do...

Asaj i shkëlqente ftyra nga lumtëria.

Ja si ishin rrrokullisur punët. Ja ç'ndryshime kish pësuar Zana, dhe shoqet për rreth s'mund t'i kuptionin këto gjëra... Ato një e dy do ta vështronin vëngër, do t'i hidhnin ndonjë thumb, dë t'i prishnin planet.

Të nesërmën ajd veshi si përherë përparësen e bardhë, kaloi në koridorin e ngushtë të laboratorit, ngjiti shkallët e katit të dytë dhe u ul pranë maqinës së vet.

— Dhjetë minuta vonesë, — dëgjoi një zë.

Nuk u përgjigj. Edhe ajo e dinte që ishte vonuar. Po pse ja thonë? Apo për t'i prishur gjakun? Jo pesë minuta vonesë, jo dhjetë, punë të madhë!

Pa e pasur fare mëndjen aty, ajo merrte ampula nga një kuti dhe i hidhte në tjetrën. Sikur s'i bënin duart fare. Mendonte gjithnjë Petritin, përfytyron shëtitjen që kishin bërë një ditë më parë dhe takimin që e priste.

U hap dera. Hyri shefi i repartit, një mesaburrë.

— Zana, pse erdhe vonë?

Ajo as që i ktheu sytë nga ai.

— Më shurdhuat me këto pse-të! — U përgjigj, dhe vazhdoi të stamponte. Shefi mbylli derën dhe shkoi në drejtori, kurse Zana as që u shqetësua fare. Shoqet e vështruan me habi

— Ç'ju duhet juve? A ju hyn gjë në punë? Jo? Atëhere mos u bëni merak për shefin. E ka gjetur ai, gjithmonë me mua, sikur s'ka punë tjeter.

— Po ne pér tē mirën tēnde... — Zana sie la Ritēn tē mbaronte.

— S'kam nevojë pér tē mirën tuaj, dëgjoni?

— Po, pse? — Bukua ju afrua pranë, i mbështeti dorën te supi.

— Pse? Ti, kur ke qejf, punon pér bukuri. Po tē duash ti jo që bëhesh shoqja jonë; po edhe na e kalon.

— Shoqja juaj?... — Në buzët e saj lodroi ironia.

— «Çfarë kujtojnë ato?... Mos mendojnë se janë më tē mira se unë?...»

— Hë!... — ja bëri nëpér dhëmbë dhe vështroi nga ato. Rita dhe Bukua panë njëra tjetrën tē çuditura.

— Shumë mënd shisni me atë titull, që po ju japid... Nuk e shikoni, edhe pa titull jäm pér bukuri...

Të gjitha vajzat heshtën. Vëtëm maqinat nuk pushuan.

Zanës zuri t'i dhembë koka. Ajo merrte me përtim ampulet nga një kuti, i stamposte!

...Ampule, ampule... Doran merrte pa pushtim. Merrte hidhje e merrte përséri... Sytë as gjë s'shikonin.

«E kur do tē mbarojnë gjithë këto ampu-la?...» vëtëm pér këtë mendon.

Të nesërmen e kësaj dite, në drekë, si përherë, ajo ngjiti shkallët pér në katin e dytë. Disa vajza, që zbrisnin shpejt, e shikuani me qortim, kthyen kokën dhe diç pëshpëritën. Në koridorin e gjatë thirrëm:

— Zana, në drejtori!

I zbriti shkallët ngadalë. Kur hyri në drejtori, vuri re pranë tavolinës së gjatë tē drejtore

shës Bukon, Vekon dhe Ritën. S'arriti të thoshte as mirë dita. E urdhëruan të ulet. Pastaj drejtoshi resha ju drejtua me rreptësi vajzave:

— Në rast se tek ne përsëritet edhe një herë ajo që ndodhi, ta dini se do ta pësoni keq...

Ato vështruan njëra tjetrën me habi.

— Akoma s'e paski marrë vesh? Jua them unë atëhere. Nga pakujdesia juaj, mund të ishin marrë më qafë kushedi sa veta. Në Kutinë ku duhej të ishin vitamina B 12, kishit vendosur dhe striknin! Kush e bëri këtë?... Kush stamposi vitamina dje? Flisni!

— Të gjitha, përveç Zanës, ulën kokën. Ajo vështronë herë njerën, herë tjetrën dhe lëvizte gishtërinjtë me nervozitet.

— Nuk flisni?... Atëhere ju lajmëroj se nuk keni të drejtë të luftoni për të marrë titullin «skuadër e punës socialiste».

— Të gjitha kemi stampuar, — tha Bukua, pa vështruar fare nga Zana.

Po ajo u ngrit ngadalë. Ju drodhën duart. Ndjeu të ftohet.

— Unë nuk mundem të punoj më në këtë repart... Ato s'kanë stampuar vitamina. Jo. Vetëm unë kam stampuar... Unë jam fajtore. Më hiqni vërejtje. Po unë... Nuk jam në gjendje... Domi t'ju ngatërroj dhë ndonjë gjë tjetër? Atëherë më lini...

— Domethënë se e ke bërë ti? S'je në gjendje?! Ç'ke... Pse s'punon me mënd në kokë?

Drejtoresha u rrëmbya.

Zilja e telefonit e ndërpreu. Pyetën për të njëjtën gjë. Ajo i siguroi që të mos bëheshin merak, sé kontrollit nuk i shpëtonte asnjë gamim.

— Ikëni, u sqarova tashti, — u tha ajo vajzave.

Zana i ngjiti shkallët duke vrapuar; hapi derën dhe u ul në karrige; qau.

«... Një shkak duan dhe gati janë të më përjashtojnë.... Po sikur?...» Duart i dridheshin, s'i bëhej fare të punonte... Pas pak, dikush hyri dhe lajmëroi se në orën katër do bëhej mbledhja e organizatës së rinisë. Asnjë s'duhej të mungonte. Zana u trullos fare. Vështroi nga Rita e Bukua, që punonin të pikëlluara, kërciti dhëmbët.

— E çë? Ç'do të më bëni?... Do të më varni?... Spiune!...

Vajzat heshtën. Ato as vetë s'e dinin si t'ja bënин hallit.

Dhe Liria, sekretaria e partisë, hyri e alarmuar. Thërriti Bukon.

...« Edhe ajo për mua ka ardhur sigurisht...» mendoi Zana dhe u inatos më keq. «Sikur s'kanë punë tjetër» Ajo qeshi me të madhe. Askush nuk i foli.

Kur mbaroi puna s'i hodhi sytë askujt. Doli me të shpejtë përjashta, pastaj hyri në sallë. U ul afër dritares, ktheu andej karrigën dhe filloi të sodisë natyrën. Veten e hiqte të qetë, por gjithë vëmëndjen e kish përqëndruar te bisedat, që bëheshin rreth e qark dhe përtypte një pastë.

— Si i shkon poshtë ajo që ha dhe s'i mbetet në grykë! — tha dikush.

— Ha, ha, ha, — ja krisi gazit ajo me të madhe dhe vazhdoi të vështrojë nga dritarja.

«Sidoqoftë, unë jam heroinë... Të gjitha flasin vetëm për mua» — mendoi ajo.

— Fillojmë? — u ndie një zë nga tavolina e

presidiumit. Zana as që e ktheu kokën. Përtipej dhe vështron te nga dritarja.

— Fillojmë, po e përsëris, — tingëlloi po aizë.

— Të gjithë shikuani nga ana e saj.

— Se mës ka turp! — tha njëra.

— Të kishte, s'do ta bënte atë që bëri.

— Ktheu këtej, Zana!

— S'më ka marrë malli të të shoh!... — u përgjegj ajo thatë.

— Dhe i thua vetes e re!

— Si s'të kemi dhënë dërmën me kohë!... — tha një punëtore e inatosur pranë saj.

Zana ja nguli sytë e zemëruar, donte t'i përgjigjej, po e mblođhi veten. U bë dyllë e vërdhë në fytyrë. Iu morën mëntë.

«Po sikur t'më përjashtojnë me të vërtetë?... Si s'e kam menduar këtë gjë! — u merakos ajo.

Uli kokën dhe filloi të dëgjonte Bukon, që kishë marrë fjalën:

— Nuk do të zgjatemi shumë. Çështja është vetëm pér një njeri dhe mendoj se është e kotë të përsërisim ato që dimë. E në ç'mbledhje s'kemi fofur pér Zanën?! Ajo asgjëje s'i ka dhënë rëndësi, prandaj mendoj se duhet marrë një mësë. Fjalën e kini ju...

Bukua vështroi nga Zana, që rrinte kokë ulur.

— Unë propozoj ta përjashtojmë nga organizata e rinise, — tha dikush.

Zanës iu errën sytë. Lot të nxeh të pikuan mbi dorë.

— Kurse unë... — Dhe vajzat flisnin njëra pas tjetrës. «Mos më bëjnë veshët? Apo mos jam në ëndër?» Ajo nuk kuptonte asgjë...

— Cfarë?! — Uli kokën me rrëmbim dhe filloj të qajë me të madhe.

— Kush është për përjashtim? — përsërithi Bukua.

Zana pati fat. Shumica vendosi që, këtë radhë, t'i hiqej një vërejtje e rëndë me shënim në biografi.

### 7.

Një javë më vonë, kur Zana kish vendosur të sillej ndryshe, duke nxituar për në laborator, ndjeu se dikush e thirri nga pas. Ktheu kokën, fare pranë saj pa një grua të panjohur. Ajo i kérkoi të falur, që e ndali ashtu papritur dhe shprehu dëshirën të njiheshin; pastaj i tha se ishte rrobaqepëse dhe se, së shpejti, disa modele të saj do të figuronin në ekspositën e modës. E kështu, rrrotull e rrrotull, ajo e solli fjalën atje ku deshi: i propozoi Zanës, që t'i vishte ajo fustanet e saj në atë ekspositë. Si shpërblim, i tha se do të merrte një shumë të mirë. Zana u bë gati të kundërshtonte, po kur dëgjoi që bëhej fjalë për lekë, u gjallërua pak; filloj të dëgjojë më me interesim.

Ajo ëndëronte prej kohe për një fustan murar, bojë qielli me xixa, të gjerë, që të hapej e të përdridhej kur ajo të rrrotullohej në krahët e Petritit, një fustan që t'i habiste të gjithë.

Ndaj e pranoi propozimin dhe të enjten, d.m.th. atë ditë në orën katër duhej të paraqitej në rrobaqepësi.

«Në orën katër...» Ajo mendonte vetëm këfë gjë, kur mori ampulen e fundit përmë stampuar; pastaj zgjati dorëh të merrte borsën; nxori kreherin. U pa te xhami i dritares dhe u bë gati të ikë.

— Vajza, shpejt në mbledhje! — tha Rita.

Zana vështroi më dyshim nga ajo.

— Ju kemi lajmëruar që dje, — tha përsëri Rita. — Kemi takim me kombinatin...

«Dje!.. Ajo dje s'kish qenë fare në të; as që kish dëgjuar gjë. Gjithmonë do t'i dilte gjë-sendi përpara!

Zbriti shkallët me të shpejtë; hyri në drejtori; kërkoi lejë. Aty i thanë se është e pamundur. Takimi më gratë e kombinatit kish mjaft rëndësi përmë të gjithë, dhe aq më tepër përmë Zanën.

— Po... — Ajo s'arriti të mbaronte fjalën. Drejtoresha ngriti supët.

— S'kam ç'të të bëj — dhe i ra telefonit. Zana ngrysi e iku tërë inat.

«Eshtë ajo, se po të ishtë ndonjë tjetër... Oh, do ta kishin lejuar fët e fët... Ta sjellin në mafë të hundës këto. Të ikësh e mos t'i pyesësh fare... Kështu është duan.» mendonte më vete.

Tërë hundë e buzë, u ul në një stol nga mesi i sallës, afér Dritës, një shoqe nga reparti i solucionit.

Punëtorët e kombinatit hynë në sallë. Drita se çfarë i tha Zanës. Kjo vetëm tundi kokën e s'i dha asnjë përgjegje. Duartrokositjet s'kishin të sosur.

— Tek nje kanë ardhur përmë shkëmbim eksperience një grup punëtoresh nga kombinati «Stalin», — u dëgjuau zëri i fortë i drejtoreshës.

Në sallë ra një qetësi e madhe.

— Të gjitha këto shoqe, që shihni këtu, marrin pjesë në brigadën, e cila disa ditë më parë fitoi titullin «Brigadë e punës socialiste». Kjo brigadë kryesohet nga shoqja Ana Bani.

Zana s'i hiqte sytë nga zeshkania sykaltër, që qëndronte pranë drejtoreshës, buzëqeshte dhe duartrokiste e gëzuar me gjithë zemër.

Pasi bëri një hyrje të vogël, drejtoresha ja dha fjalën Anës. Zana shkruajti në një pusulle: «Unë jam kriçë.» E zuri atë me një gjilpërë me kokë dhe ja vuri në shpinë Lules, që qëndronte para saj nga e majta. Drita e pa dhe qeshi. Lulja, pa ditur gjë, ktheu kokën plot gaz.

— Edhe gëzon! — ja bëri Zana dhe qeshi me zë.

— Pushoni! — thërriti dikush, kurse një grua hoqi pusullën nga shpina e Lules, e bëri copa-copa dhe ja hodhi Zanës përpara.

— Bëre heroizëm të madh! — i tha ajo me tallje dhe u fryu copave të kartës në drejtim të saj.

— Pushoni! — thirrën përsëri.

— S'dua.

Asaj s'ja zgjati askush. S'dinte ç'të bënte. I ra Dritës me bërryl, grryejti diçka në tryezë; vështroi nga presidumi. Ana fliste qetë e kuptueshëm.

Pastaj u ngirit Rita. Kjo falënderoi gratë e kombinatit dhe u zotua përpëra tyre, në emër të brigadës, se ajo dhe shoqet e saj do t'i kryejnë më së miri detyrat që u dalin. Nga brigada e tyre u bë ky propozim: përfshirëtëzimin në maksimum të maqinerive, të krijohet një turn i dytë, në disa raste dhe një turn i tretë.

Rita heshti; priste përgjigjen e shoqeve.

Zhurma përshkoi sallën. Vajzat e gratë pësh-përisnjn.

— Ne japim dy veta. Të gjitha jemi të një mendimi.

Një grua dyzetyjeçare vështroi e kënaqur përqark. Ishte krenare.

— Edhe ne! — salla gumëzhiu si koshere bletësh.

— E kush do të punojë pas dite dhe natën? Rita?... — tha Zana.

— Ju që jeni çupa, u përgjegj një grua aty pranë.

— Punoni vetë ju, ju që... — po nuk e zgjati. Shumë sy e vështronin. Ajo heshti.

Mori një copë kartë e bëri fishek, pastaj e vuni në gojë, i fryu dhe, me ndihmën e gishtërinjve, e hodhi mbi kokën e të tjerave.

— Raketa e parë! — i tha Dritës dhe qeshi.

— Zanë! — i folën nga pas. Ajo s'e kthëu kokën.

Në sallë u vendos prapë qetësia. Po prapë kjo u prish nga ajo zeshkania sykaltër. Ana foli plot zjarr e entuziazëm; pastaj heshti, treti vështrimin në dritaren karshi e, si të kujtohej për diçka, u drejtua nga punëtoret.

— E dini çfarë? A s'do të ishte një meritë e madhe e atyre që luftojnë për të fituar titullin «brigadë e punës socialiste», sikur ato në punë, me ndihmë, t'i tërheqin në radhët e tyre punëtoret, që janë të prapambetura?

## 8.

Zana kish gati pesë minuta që priste në drejtori. Ishte ulur në një karige pranë tavoli-

nës dhe vështron te pa kuptim nga dritarja. Liria, që e thirri, se nga u zhduk dhe ende s'po vinte, kurse asaj, Zanës, i dhëmbte koka, i merrjej fryma dhe s'mund të priste dot.

«E padurueshme kjo pritje... E ç'do t'më thonë? Të përjashtuam! Mos të vish më! Po, po, kështu do thonë. Më fshinë nga defteri. S'ka më laborator. Dje e tepërova fare. Sí do të bëj pastaj? Ku do të mbytem? Një punë tjetër? Po shënim i në librezë? Apo të shkoj e t'i bie në gjunjë xhajës?? — mendonte Zana e shqetësuar.

Ajo s'luajti fare nga vendi kur u hap dera. Liria hyri me një tufë shkresash në duar.

— Paske ardhur?!

Ajo nuk u përgjegj. Gjithë vëmendjen e kish përqëndruar në një pjesë të tavolinës mbi të cilën lëvizte pa pushim gishtin e madh. Shqetësimi nuk i shqitej.

«Ja, tashti Liria do të hapte gojën dhe do ta lajmëronte, do ta dëbonte dhe kushedi se ç'do t'i thoshte...

Liria u kollit. Se ç'rregulloi në tavolinë, pastaj, iu drejtua Zanës:

— Po, mbaje mend! — se herë tjetër ne s'marrim parasysh asgjë. S'të falim më. Tashti duhet të kërkosh falje para kolektivit.

Zana rrrotulloi dy-tri herë sytë e mëdhenj dhe të kaltërt, pastaj u ngrys në fytyrë.

— Falje? Përse? Unë mund të gjej punë edhe në ndonjë vënd tjetër. Kudo mund të punosh sot. Ndoshata aty s'do të më trajtojnë kësh-tu, ndoshata do të ketë shoqe më të mira... — Ajo ja dha të qarit.

— S'ke të drejtë, Zana, s'ke të drejtë aspak...

Një ditë do ta kuptosh këtë dhe do të pendo-hesh. Këtu do të jemi. Sa që nuk e ke kuptuar ç'shoqe ke! Shoqe të mrekullueshme! Ritën, Bukan, Vekon, Lizën e sa e sa të tjera. E di ç'kanë menduar ato? Të hyjnë në garë me ty, kush do ta marrë e para titullin e anëtarit të brigadës së punës socialiste.

Zana përsëri ngriti sytë.

I bënë veshët apo çfarë?...

Liria vazhdoi:

— Ato bënë një mbledhje, ku të cilësuan ty të zonjën për këtë punë...

Zanës i u kujtua se para ca kohe Rita, Buka, Vekua dhe Liza shkuan në drejtori. Atë e lanë vetëm. Kur u kthyen, ato ishin ca si të gjallëruara, po asaj s'i folën fare.

— Pse talleni? — tha Zana me zë të dre-dhur.

— Jo, e kam me gjithë mënd. Detyra jote e parë është të sillesh sa më mirë, që të të hiqet vë-rejtja që ke marrë.

Sytë e Zanës shkëlqyen.

— Pastaj, duhet të vazhdosh shkollën. Pa këtë nuk bëhet. Mund të japësh provimet me korrespondencë. Do ta mendojmë dhe më vonë këtë. Ikë, tashti. Si thua, mirë?

Liria i zgjati dorën.

Zana, si e trembur, e kapi atë dorë, pastaj iku me vrap.

Po ajo u kthye përsëri: — Këto ditë kam pak punë pasdite, do të figuroj në ekspozitën e modës. A mund të ma rrëgulloni të punoj në mëngjes? Gjer në Vitin e Ri? — Liria i buzë-qeshi.

— Pse jo! Veçse dua të të them një gjë. Po

të punosh si duhet, ti ke mundësi të fitosh edhe këtu.

Zana as vetë s'e kuptoi si i ngjiti shkallët. Zemra i rrihte fort, fort. U ndal në koridor, u mbush me frymë, hapi derën. Të gjithë e printën plot gaz. Ajo vetëm buzëqeshi; Filloi të stampojë e në çast ndjeu diçka të paspjegueshme në kraharor, diçka që e lëndoi dhe e gëzoi. Një «pse» e madhe, një «pse» e rëndë e vështirë për t'u zgjidhur i vërtitej në kokë.

«Pse vallë? Pse sillen kështu më të?» E në të njëjtën kohë i erdhi edhe turp nga vetja e saj. U skuq e tëra. I kujtohej se një ditë më parë, si kish dalë nga mbledhja, ajo kish shkuar te rrobaqepësja. Pastaj kish takuar Petritin.

— Më dukesh e mërzitur, — i kish thënë ai.

Dhe ajo i ish hedhur menjëherë.

— Më thuaj, Titi, a s'kam të drejtë? Ngrihen, propozojnë, shesin mënd para të gjithëve jo të punojmë me dy turne, jo me tre. Për mendtë e tyre ta pësojmë edhe ne, të mbyllemi gjithë pasditen brënda mureve. As kinema, as shëtitje. Të kthehem i nё orën njëmbëdhjetë të natës nё shtëpi.

Dhe i kish shpjeguar fije e për pe propozimin e Ritës...

— Ty, po s'të pëlqeu, mos prano. Nxirrndonjë shkak. Po deshe, unë kam një shok doktor.

Në parkun «Rinia» ata gjetën një stol të veçuar dhe u ulën. Vështronin njëri tjetrin e,

nuk flisnin. Thellë nga parku dëgjohej melodja e një muzike. Rreth e qark ishte errësirë. Gjethet thuajse nuk lëviznin fare...

Zanës nuk i pëlgente heshtja. Sidomos kur ishte me Titin. Mundohej të gjente diçka, fundja një fjälë, sa të çelte bisedën.

— E dëgjove atë djalin që rëcitoi? — Petriti e vështroi në sy.

— Simpatik ishte.

Gjethet, si të trembura nga një fllad që fryu, u drodhën lehtë.

— S'e kam fjalën aty. Sa bukur e kish shkruar!

Aj heshti, heshti dhe dëgjoi si në èndër... Përsëri gjethet u drodhën. Ai vështroi Zanën.

«Vërtet ajo po flet?... Shiko, dreqka, ditka dhe nga këto?...» tha me vehte.

— Pse s'flet? Apo s'të pëlqejnë. Doemos, je gazetar ti!

Petriti i kapi dorën. Ajo s'kundërshtoi. Vështrimin e kish tretur diku larg në errësirë. Diç ndjeu në kraharor, po as vetë s'e dinte se çfarë ndjenje ishte ajo. Për një kohë të gjatë, ata përsëri heshtën.

— Thuajmë ndonjë gjë! Ti s'po flet fare.

— Ç'të them?... — Pastaj shtoi:

— A shkojmë nga kisha e Shën Prokopit?...

— Oh, jo! S'u kam thënë në shtëpi se do të vonohem. Ne për sot nuk kishim lënë takim.

— E di, po punë e madhe!

— Jo, jo, Petrit, një herë tjetër. Pranverën përparrë e kemi... Ku nuk do të shkojmë! Apo jo? — ajo qeshi. — Ke shkuar prapë me shërbim?...

Petriti nuk u përgjegj. I ra me këmbë një

guri aty pranë; gërvishti me thua mbëzhtetësen e stolit, ku kish vënë krahun.

— Gjithmonë nuk shkojmë, nuk shkojmë. Atëhere kot thua se më do!

— Pse? Po të shkojmë nga kisha, do të thotë se të dua?

Ai e vështroi me çudi.

— Kështu e kupton ti dashurinë, Petrit?

Ai s'foli. I ra përsëri gurit me këmbë.

— Domethënë nuk do.

— . . . . .

— Me qënë se nuk shkojmë nga Shën Prokopi, ikim atëhere, s'kemi ç'bëjmë. Apo rrimë që të numurojmë yjet, si budallenjtë, — tha ai.

Zana e shikoi me dyshim. Sytë ju bënë të akullt. U ngrit me rrëmbim.

— Ikim, me qënë se s'kemi çfarë të bëjmë. Ikim, sigurisht.

Afër ministrive ata u ndanë. S'i thanë asnje fjalë njëri tjetrit. Ajo mori rrugën për në shtëpi, kurse ai s'dinte nga të shkonte.

«Edhe budallaqe, edhe e mënçur, — tha me vete. — Nuk e sheh! Po do të më lutet një ditë!...»

Te shkallët e teatrit, ai dalloi shefin e redaksisë me një kolonel. Afër tyre qëndronin dy femra. Petriti u kaloi pranë, u pëershëndet me ta dhe u ndal.

— Kam një material shumë interesant, — i tha shefit dhe i hodhi një vështrim me bisht të syrit femrave, që qëndronin pranë, një gruaje zeshkane me flokë të gjatë e buzë të kuqe dhe

një tjetrës, fytyrën e së cilës nuk e shih të mirë.  
Ajo qëndronte anash, bënte sikur lexonte afishët.

— Njihuni.

Pétriti i dha dorën gruas zeshkane, ja zgjati edhe asaj tjetrës në krah, po ngriu në vend; ai ndeshi vështrimin e dy syve të zes, që shihnin fare pa përfillje.

— Njihemi, — tha ngadalë dhe vuri buzën në gaz, pastaj i shtrëngoi dorën Verës. Kur u ndanë, ai përsëri i shtrëngoi dorën dhe e vështroi kuptimplotë, pastaj i thirri një shoku të zyrës që i kaloi pranë, e zuri pér krahu dhe u nis nga ana e sahatit.

— Kush është ajo? pyeti ai si bënë nja dhjetë hapa, — ç'e ka kolonelin? Shiko, e zuri dhe përkrahu, — foli me këershëri.

— Eshtë e bija, — shoku buzëqeshi. — Mos të vanë sytë?

Pétriti nuk u përgjegj.

Verën e kish njobur në plazhin e Durrësit para ca muajve; kish biseduar disa herë me të, kish kërcyer një herë në pistë, kur ajo kish qënë me shoqe; e kish parë dhe në bulevardin e Tiranës, po kish bërë sikur s'e kish njobur. Ajo s'i dukej gjë përpara Zanës. Por kohët e fundit çështja kish ndryshuar. Ç'është Zana para saj? Një punëtore e thjeshtë, pa kulturë, mbesa e një pemëshitësi. A krahasohej ajo me Verën? Shoku i tha se ajo vazhdonte fakultetin e kimisë, se do të dilte inxhenjere. Ishte vajzë e vetme e kolonelit. A kish krasim? Vërtet ndonjë bukuris'kish, po sytë e zes të tërhiqnin mjaft. Pastaj s'mund të thoshq që s'ishte simpatike. Ajo kish një trup mesatar dhe të ngjeshur. Vetëm

këmbët sikur dukeshin pak të shtrëmbëra, po edhe ato s'prishnin ndonjë punë të madhe, aq më tepër po t'i mbante fustanet nën gju.

Te sahati, si gjithmonë, kish mjaft njerëz. Turma e bulevardit lëvizte ngadalë dhe qetë. Petriti ecet kokëulur. Mendime të reja po e turbullonin. Mendime të reja i zienin në kokë edhe Verës.

Petriti, kur i dha dorën, ja shtrëngoi me aq përzemërsi sa asaj iu duk se ja hoqën atë gozhdë të tmershme që i shponte gjoksin, atë gozhdë që kishin ngulur sytë e tij mospërfillës. Zëmëra iu drithërua dhe fytyra i shkëlqeu kur u largua ai.

#### 10.

Zana doli e gëzuar nga rrrobaqepsia. Prova e fustanit i doli shumë mirë, ashtu si e kish menduar ajo. Në paradën e modës, që u hap para ca ditësh, ajo pati shumë sukses. E duartrokitën më shumë nga të tjerat. Zana buzëqeshte e lumtur. Asnjë herë s'e kishte përfytyruar veten e saj aq elegante, me çantë dhe doreza si këpucët, me fustane e kostume aq të bukura.

Ajo vrapi i në stacionin e autobuzave. Në ora katër kish mbledhje. Do të fliste Bukua mbi disa çështje, që ishin shtruar ca ditë më parë në një konferencë të rinisë të Tiranës.

Si përherë, u ul në kolktuk e u tret në mendime. Mendime për Petritin, për të ardhmen. Ai, si duket, ish zemruar. Po ç'faj kish Zana? Si të donte ai do të bëhej? Edhe ajo kish tekat e saj. Pastaj... Sidoqoftë, në rast se ai e dashuron-

te do t'i largcnej edhe zemërimi. Ky mendim e gjallëron.

— Si të mos e dashuronte? Si të mos e donte Zanën?

Ajo as që i kish bërë fjalë për fustanin, Ishte një surprizë për Vitin e Ri, që kishin vendosur ta festonin bashkë në pallatin «Ali Kel-mendi», ose në ndonjë vënd tjeter.

Autobuzi ju afroa laboratorit. Zana u ngrit nga vëndi, zbriti, shpejtoi në rrugicën e vogël. Oborri ishte i zbrazët. Te dyert s'kish asnje njëri. Ora ishte katër plot. Sa hyri në koridor, dëgjoi zhurmën që erdhi nga sala e madhe. Kjo ishte mbushur sa s'kishe ku të hidhnje mollën. Dikush fliste me zë të lartë. Një tjeter queshtë. Ajo vështronë rrëth e qark, s'dinte nga të shkonte; dëgjoi zërin e Rites.

U tremba; kujtova se ishte vonë; desh u përplasa te dera.

— Ja, po vinë.

Presidiumi zuri vënd. E mori fjalën Bukua. Zana nuk e dëgjoi. U skuq në fytyrë. Ju kujtua ditë e takimit me gratë e Kombinatit.

Pastaj vështroi Bokon që fliste me aqë shkathtesi. Asgjë s'kuptonte nga ato që dëgjonte.

— Sa mire, eh! — i tha Rita.

— Po... — Ajo tundi kokën.

— Ta bëjmë dhe ne si ata. Si thua ti?

— Po. — Më tepër s'dinte c'të thoshtë. Bukua u ul. Punëtoret filluan të diskutojnë njëra me tjetren. U bë zhurmë. Pastaj u ngrit dikush. Të gjithë e dëgjuan me vemenje. Zana më tepër se kushdo i bëri veshët katër.

«Të jem brënda e mos të marr vesh?» —  
qortoi ajo veten.

Pastaj Rita sqaroi çdo gjë.

— Edhe brigada jonë do të mundohet të  
rikonstruktojë maqinat, që janë jashtë përdorim.  
rimit.

Duartrokitje, Ajo buzëqeshi. Foli përsëri.

— Ja, qysh sot do ta lë maqinën që kam e  
do të punoj me një të vjetër, nga ato që s'i  
përdorim fare.

«Ja si qënka puna!» — tha Zana e ndjeu t'i  
merrej fryma. Dicka e shtrëngoi në kraharor.

— Budallaqja, sa e rrëmbyer që jam! Za-  
na u mundua ta përbante veten, se per pak  
desh u ngrit të thosh: «Edhe unë do të punoj  
me një maqinë të vjetër».

Rita u ul. Sofia, që s'kish as dy javë që  
punonte në repartin e tyre, se ç'pëshpëriti. Za-  
na dëgjoi. Dëgjoi kur i tha Rites:

— Maqinën time, që është e re, po ja jap  
Zanës. Unë do të punoj me tënden.

— Pse?

Rita u mvrejt. Pastaj shtoi:

— Zana ka më tepër përvojë se ty.

— Sidoqoftë...

Ajo s'arriu të mbaronte. Këtë radhë Zana  
s'e mbajti dot veten. U ngrit me rrëmbim...

— Me lejë?

Të gjithë vështruan nga ajo.

— Edhe unë do të punoj me një të vjetër.  
U bë zhurmë. Dikush qeshi. Ajo u skuq.

Bukua filloi të duartrokasë. Pastaj duartro-  
kiti gjithë salsa. Liria buzëqeshi. Zana ndjeu  
dicka të pakuptueshme në zemër.

Vajzat dolën plot zhurmë në oborrin e

laboratorit. Sa kish filluar tē errësohej. Morën rrugën pér nē stacionin e autobuzit e pér pak u ndodhën nē atë tē Durrësit.

— Zana me! Bukon u drejtua nga sheshi «Skënderbej». Dritat neon u jepnin rrugëve një ngjyrë tē zbetë. Të dukej sikur ngrihej një afsh i ngrohtë nga trotuari, një mjergull e lehtë. Yjet ndriçonin aty këtu dhe thua se një dorë fëmije kish pikëzuar nē quell ca pika herë tē mëdha e herë tē vogla.

— Hynë nē vargun e atyre që kalonin bulevardit. Ajo veshtronte pa ndërprerje nga e majta; nevrikosej. Petriti as që dukej nē vargun pambarin tē njerëzve.

— Ikim, si thua?... — i tha Bukua.

— Mirë, ikim... — u përgjegj ajo pa qejf.

U kthyen përsëri nga ana e rrugës së Durrësit.

— Po hajde tē marrim nga një hashure. — Zana e tërhoqi Bukon. Ajo nuk kundërshtoi. U futën nē pasticeri. Njerëz tē njobur dhe tē panjohur hynin e dilnin. Pritën nē radhë. Pastaj me tase nē dorë shkuan afër dritares dhe qëndruan aty; vështronin nē rrugë.

— Qenka shumë e nxehjtë!

Zana s'u përgjegj. Ajo s'e hoqi vështrimin nga ana tjetër e bulevardit. Afër dyqanit tē luleve Petriti po bisedonte me një vajzë. Sytë e tij qeshnin. Ai fliste pa pushim, fliste dhe buzëqeshte.

«Kush tē jetë vallë?...» mendoi Zana plot cmirë.

— Büko, hajde tē shkojmë!... — e la pa mbaruar hashuren mbi tavolinë dhe bëri nga dera. Po Petriti i dha dorën vajzës me rrobe jeshi-

le. Ajo e përshëndeti dhe u kthye. Zana u zbeh.

«Vera? Shoqja e saj e klasës? Ku e njeh Vera Petritin?» — tha si nëpër dhëmbë.

Donte t'a takonte e ta pyeste, po ai humbi në turmën e madhe të njerëzve.

U kthye në shtëpi e s'donte të hante. E shtrire mbi minder, mbylli sytë, mendonte e trish-tohej. Kjo natë i dukej kaq shumë e gjatë. Orët zvarriseshin ngadalë, ngadalë, kurse ajo donte që të fluturonin. E priste me padurim agimin. Atëherë çdo gjë do të sqarohej e ajo do të ishte e qetë si pérherë.

Të nesërmen mori në telefon Petritin. E pyeti në e kish apo jo një libër. Ai iu përgjigj se mund të gjejë në librarinë e bulevardit. Zanës ju drodhën duart. Heshti. Ai priste andej. Kjo këndeji.

— Alo?

— Hë!

— Petrit.

Përsëri heshti; s'dinte ç'ti thoshte; u zverdh në fytyrë.

— Takohemi sot?

— Jam shumë i zënë këto ditë.

Asaj ju morën mëndtë. Ngadalë fare, si e mpirë, lëshoi receptorin. Kur hyri në dhomë, shoqet e vështruan të shqetësuara.

Zana mori ampulen, por mëndjen e kish te Vera.

«Ajo. E kush! Ç'e kujton ajo veten? Sa budallaqe që jam! E nga kush trëmbem? Petriti do të vijë në mbrëmje, do të më shohë me fustanin muar. Ai pa sy s'është. E ç'ka ajo më të mirë se unë?» — u mundua të qetësojë veten.

— Duhet të ndjek shkollën edhe unë. Fjalën

ë kam dhënë dhë dûhet tâ mbaj. — vendosi Zana  
fisë në fund.

## 11.

Zana dhe Bukuâ kishin dy ditë që punotili  
nëtën. E kishifi pak vështirë, po megjithatë plas-  
nin e kanë realizuar.

— E, si kaluat? — u tha Rita tërë gaz sâ  
hyri brenda.

— Erdhe? Vajti ëra? — e pyesin Zana dhe  
Bukuâ më një gjë.

— Dëdhe dhjetë minuta të vejë shtatë. Jâ;  
po vjen dhë Liza. — përgjigjet ajo.

— S'paske fjetur mirë sonte. Të qenkan fry-  
rë sytë. — Zana lë ampulën e fundit. Ngrihet.

— Hajde Buko, Çohu! U kemi hua dhjetë  
minuta. Si thua? Jua shpërblejmë me dyfishin?  
Si u veshën, Bukuâ dhe Zana morën rrugën  
më këmbë. Për fat autobuzi u kaloi pranë dhë;  
me një shenjë të tyre, qëndroi; s'kaluan as pesë  
minuta dhe ai u mbush plot.

Në rrugë kish lëvizje të madhe. Njerëzit  
ecnin, në drëjtme të ndryshme; ecnin me hap  
të shpejtë, sikur vrapiçin. Zana, si u përshtendet  
me shoqën, zbriti në stacionin e parafundit, i hi-  
pi një dëshirë të ecte në këmbë, të sodiste Tira-  
nën në një mëngjes dhjetori.

Frynte pak erë e ftohtë. Ajo ngriti jaken e  
paradesysë, e mbértheu gjer në grykë dhe vazhdoi  
të ecë me ngadale.

Shpejtojnë. Të gjithë shpejtojnë, as koka  
nuk kthejnë.

S'kishte aspak dëshirë të kthehej në shtëpi! Kish përpara një ditë të tërë. Ç'do të bënte, ku të shkonte? Mori rrugën nga Tirana e re. Një mjer-gull e hollë zvarrisej rrreth kodrës, mbi Universitet. Parqet, nga të dy anët e rrugës, gjelbëronin, megjithëse ishte dimër. Dëgjoheshin zëra fëmijësh, të qeshura të rinjsh.

Kur u kthyё nё shtëpi s'mund të shkëputej nga pasqyra. Fustani muar asaj i kish dalë si askujt tjetër. Atë e patën lënë dy ditë nё vitri-nën e rrobaqepësisë dhe kushdo që kalonte an-dej, ndalej që ta shihte. Vetë Zana qëndroi dy tri herë pranë njerëzve që e vështronin dhe dë-gjonte me vëmëndje ato që thoshin.

— Kur s'kanë shkruar se i kujt është! — mendonte nё ato çaste.

Rrobaqepësia i tha se brënda atyre ditëve tri vajza të tjera kishin porositur fustan si ai, po ajo s'duhej të mërzitej, se si Zanës, askujt s'do t'i shkonte.

Dhe me' tё vërtet ajo dukej e mrekullueshme. Ç'ishin artistet e filmave? Zana ishte yll para tyre. Flokët e gjata e valë valë mbi supe i shkël-qenin plot bukur. Këpucët e bardha e tregonin mjaft elegante.

U zvesh me tё shpejtë; veshi po ato rrobe që kish dhe doli nga shtëpia.

Edhe pёr dy ditë ishte Viti i Ri dhë ajo as që kish biseduar me Petritin. Kish gati një ja-vë që s'e kish parë. E mori nё telefon nga MA-PO-ja. Ai i tha se natën e Vitit të Ri e kishin caktuar me shërbim dhe se i vinte shumë keq që ndodhi kështu; i uroi asaj një vit të lumtur e të mbarë.

Zana u hutua aq shumë sa s'dinte ç'ti thosh-

te. Shkoi në shtëpi; u shtri, po gjumi nuk e zuri.  
C'nuk mendoi!

— «Pa tjetër ka shërbim. Si do të më gënjejë?»  
— përsëriste me vete.

— Pasdite ajo u takua me Bukon, i ranë bashkë rrëth e qark bulevardit, po nuk e panë gjë kundi Petritin.

— Ku do ta festosh Vitin e Ri? — pyeti Bukua Zanën.

— Në asnje vënd.

— Pse? Ti the në pallat.

— Po... — Zana ngurroi t'i hapej Bukos. Pastaj e vështroi atë në sy dhe i tha ngadalë:

— Do veja me një shok aty...

— E mora me mënd, — ja priti Bukua.

— Pse?

— Të kam parë me të.

— E, si?

— Kështu duket i mirë... Po unë s'e njoh... Zana uli kokën.

— Ai ka shërbim atë natë.

— Po ti hajde me nel...

— Jo... Kisha dëshirë me të...

Tek cepi i rrugës pa xhajën e vet që bisedonte me një shok. Zana e pëshëndeti lehtë me kokë dhe kaloi pa bërë zë.

— Kush është kjo? — Shoku s'ja shqiti sytë Zanës gjersa ajo u zhduk në rrugicë.

— Mbesa ime, e kam rritur si vajzë... — u përgjegj Muqua.

— Qënka e bukur! — buzëqeshi tjetri.

Ata vazhduan bisedën e mëparëshme, pastaj u përshëndetën, duke i shtrënguar dorën njëri tjetrit.

— Shiko, kije kujdes mbesën... T'i gjejmë

një djalë për kokë. — s'harroi të thoshte shoku.

Muçua në fillim buzëqeshi. E vështroi pa të keq shokun dhe mori rrugicën, por befas i shkël-qyen sytë: «Një djalë për kokë... Mos e ka ndër mend për ndonjë njeri të tij?»

Ktheu kokën, porse shoku ishte zhdukur.

«Si nuk ka menduar më parë? Si ka harruar fare se Zana mund ta lidhë me miq të mirë? Ka dy pëllumbesha në shtëpi dhe s'kujdeset fare për to...» qortoi Muçua veten.

— Po përgatitemi, apo jo? — thirri ai plot gaz sa hyn në koridor. — Do ta festojmë si jo më mirë këtë vit. — Zveshi pallton dhe ja dha së shoqes. Zana zbriti shkallët ngadalë dhe vështroi nga ata.

— Hajde te xhaja! Hajde, — i thirri ai.

Ajo u shtang në vend. Nuk u besoi veshëve. Ishin bërë gati katër muaj që ai e vështronte vëngër, i gérthiste.

— Si thua, s'duhet të na gjejë Viti i Ri të zemëruar... — ai e përqafoi, i ra dy-tri herë krahëve. Zana buzëqeshi ëmbël. Muçua e pa dhe u kënaq.

— S'besoj të kini gjë andej nga puna. — i tha butë. — Do ta kalojmë bashkë Vitin e Ri, si thua?

Zana tundi kokën. Dita vajza e Muços qëndronte mënjanë dhe qeshte. Në ato çaste, asaj i dukej i ati aq zemërgjërë, aq i mirë e i dashur, sa që i vinte t'i hidhej në qafë e t'i thosh: «Më fal, baba, që mendova keq për ty...».

Se Dita ishte mërzitur shumë nga i ati. Një ditë, para se të shkonte në shkollë, ish kthyer në dyqanin e tij. Kish dashur të merrte diçka për të ngrënë në pushimin e madh. Kur kish

zgjatur dorën te portokallet, i kishin vajtür  
sytë te çmimi i tyre.

— Babil mós e ke shënuar gabim çmimin?  
— pyeti.

— Njëqind duhet të jetë, — ti përgjigj ai  
thatë.

— Një qind?! Vërtet? Po shteti i ka pesë-  
dhjetë lekë.

— Prandaj, lëshoje portokallin se më kushton  
njezët lekë. — Dita mori çantën dhe iku  
më vrap. Nuk e ktheu asnjëherë kokën.

«Baba i thënçin! Mirë ja bën Zanë... Po  
do ta shohë po s'ja punova edhe unë...» tha më  
vete.

12.

Muçua hyri në dhomë i gjëzuar.

— Gjëjeni ç'kam këtu! Hë, kush e gjen?  
— thirri ai.

Të gjithë vështruan më habi.

— Hajde, Zanë, te xhaja... — Ai i vari  
në qafë një gjerdan më gurë të çmuar. — Ja  
edhe për ty, Dita...

Lija u prish në fytyrë. Nënë Tixhja u zbeh.  
Zana e Dita s'u besohin syve; ato puthën Mu-  
çon në faqe, pastaj vrapuan në dhomën e pri-  
tjes, te pasqyra...

— Hë, thoni që s'mendon për ju xhaja...  
Ato buzëqeshen; I kerkuan lejë të trinë lart,  
pranë ràdios. Mòren një pjatë me arra e me  
fiq dhe ti nisen.

— Kushti se ku është! — tha Zana.  
Dita e kupton se për kë e kish fjalën. Za-

na i kish treguar gjithçka për Petritin, asgjë s'i kish fshehur...

— Si thua?

Dita ngriti vetullat e supet njëkohësisht dhe heshti. Rádioja tránsmetonte meloditë më të bukura. Ato dëgjonin në heshtje, secila në mendimet e veta. Melodi të njohura. Tango, fokstrot, vals.

Zanës i dukej se po kércente bashkë me çiftet e tjera në sallën e pallatit «Ali Kelen-di». Buzëqeshi. Sytë e mëdhenj i lëshuan xixa. Vështrimin e treti diku.

— E di, Dita? Ja, në këtë muzikë jam njo-  
hur me Petritin... Unë po bisedoja me Lenën...  
Më dukej, se më e lumtura nga të gjitha, aty,  
isha unë. S'kisha ndjerë asnjëherë kënaqësi t'a-  
tillë. Sikur gjithë gëzimi i asaj mbrëmjeje më  
përkiste mua, sikur të gjitha gjérat ishin të  
**mijat**. Valsi sa po kishte filluar. Ndjeva se s'ki-  
sha fuqi ta përbaja veten. **Zemra** më irrihte  
fort, doja të ngrihesha, të fluturoja, të këndoja  
më zë të lartë. Në çast dikush më ftoi... Unë as  
që e pashë në fytyrë. U ngrita, i dhashë dorën.  
Ai më tërroqi lehtë dhe ne filluam të rrötullo-  
heshim në sallën e madhe. Ai ishte Petriti...

Dikush trokiti fortë që jashtë. Ato zbritën  
shkallët me rrëmbim; hapën derën.

— Erdha të të marr — i tha Bukua Zanës.  
Do të vish me ne, pa tjetër.

Zana kundërshtoi. Bukua diçka i tha në  
vesh.

— Vërtet? — Ajo s'besoi; vrapi është dho-  
mën e saj, pastaj në kuzinë.

— Më thérresin shoqet, nuk do të vonoj,  
— i tha xhajës. Ai u kollit, po s'u përgjegj.

Bukua e ndihmoi tē vishej, i mbértheu fustanin, i lidhi brezin, pastaj e veshtroi.

— Do tē mahnitësh botën. E di? Sapo e pashë Petritin që hyri brënda s'prita më.

Zana veshi pardesynë dhe, si u përshëndet me Ditën, doli.

Salla e žbukuruar e pallatit «Ali Kelmendi» që mbushur plot, kur hynë ato.

— Ku është? — pyeti Zana. — Apo më gjenjeve?...

— Mos u bëj merak, se do ta shohësh. — tha qetë Bukua.

Zana e ndjeu veten si jo më mirë. Vështronte herë nga dera, herë nga çiftet që rrëshqasin lehtë. Ishte po ajo sallë, ku katër muaj më parë ajo u njoh me Petritin, po ato melodi tē njohura, veçse tashti ajo rrinte në një vënd tjeter dhe ndjente dëcka tē çuditëshme në krahavar, tamam sikur do tē hynte për tē dhënë ndonjë provim tē vështirë.

Dhe ja, Petriti bashkë me një shok u ul në një cip. Dëcka thanë pastaj filluan të vështronin nga tē gjitha anët.

Zana nuk i hiqte sytë nga ai. E kur vështrimet e tyre u takuan ai e pa me habi, si të që ndodhur përpara një dëckaje tē papritur. I tundi kokën lehtë dhe nuk vështroi më nga ana e saj. Zana nuk e dha veten; ajo ndiqte me sy çiftet që rrrotulloheshin dhe befas u trondit; zgjati kokën për t'u bindur. Po sytë nuk e gënjen. Vera, duke u gajasur, kércente në duart e një djaloshi. Ja, ajo po i afrohej Petritit dhe i buzëqeshte.

Muzika mbaroi. Petriti afroia një karrigë pranë tij. Vera u ul e kënaqur, e qeshur, e

lumtur; rregulloi fundin e gjërë dhe filloi të pyesë pér diçka.

Zana u zverdh.

— Berti, kérce me Zanën! — i u drejtua Buka tē vällait.

Zana nuk donte tē ngrihej, po ajo e detyroi.

— Më je bërë limon në fytyrë. Hë, merr veten!...

Fustani muar filloi tē përdridhej nën tingujt e valsit. Ishte po ajo muzikë që dikur e ngriti peshë zemrën e saj, i ngjalli sa e sa shpresë, i hapi dyert e ëndërave tē bukura. Fustani muar rrrotullohej, hapej dhe zvogëlohej, duke treguar herë herë tylin e zhuponit. U ngrit edhe Petriti me Verën. Zana u mundua mos ta jepte veten, po një lëmsh sikur i zuri frymën; ndjeu, se edhe këmbët i hidhte me përtim.

Vetëm pas gjysmë ore, Petriti kérceu me Zanën. I u duk e domosdoshme që tē kércente. Po sikur ajo tē bënte ndonjë marrëzi? Sikur t'i prishte punë?...

— Sot qënke bërë peri, — i tha si me tē qeshur. Ajo nuk nxorri asnje zë; pastaj guxoi dhe pyeti.

— Ti sikur kishe shërbim?

— Po ja, ky është shërbimi. Tashti këtu, pastaj në një vend tjetër.

Ajo heshti.

— Më dukesh sikur s'je në qejf.

— Të kujtohet, Titi, katër muaj më parë se si u njohëm këtu? Ti atëhere kérceje vetëm me mua!...

— Mos do që edhe sot...

— Jo, Titi, jo... Unë s'të ndaloj... Po unë  
dua të bisedoj me ty. Kam diçka...

— Të bisedosh?... — Ai s'mbaroi. «Me të vërtetë që duhej biseduar, duhej biseduar sa më parë, urtë e butë. Duhej ndarë çdo gjë, ashtu pa të keq. «tha me vete ai,

— Mirë, në datën tre, ora pesë, te vendi i zakonshëm. Këtu s'mundem.

Asaj ju duk sikur dëgjoi një zë tjetër të ftohtë, të vrazhdë, s'guxoi as ta vështronë në sy. Muzika mbaroi. Plot vrer, ajo u kthyesh në vënd. Mëndja ju prish fare. S'dinte ku të përqëndrohej, nga c'send të mbahej. Valset, tan-got përsëriteshin e përsëriteshin pa mbarim. Petriti s'po dukej më.

Afër orës njëmbëdhjetë e gjysmë Vera veshi pardesynë dhe iku. Zana e ndjeu veten të lehtësuar. U çel në fytyrë; u gjallërua pak dhe priti me padurim ftesën e Petritit. Po s'kaluan as dhjetë minuta e ai u zhduk nga salla.

Zana e humbi fare, me zor i mbajti lotët, pastaj, si të ish kujtuar për diçka, u drejtua nga dera dhe zbriti me rrëmbim shkallët.

Një shi i lehtë lagte trotuaret. Zana vështroi nga të dy anët e rrugës; nuk dalloj njeri; hodhi vështrimin në mes të bulevardit: atje pa Petritin, që e cte me hap të shpejtë, në drejtim të trotuarit tjetër. Donte t'i thërriste, po i erdhi rëndë. Vendosi ta ndjekë pas, t'i thosh se s'kish të drejtë se... Te muri, afër rrugicës, dalloj një siluetë vajze; u bë gati të vërsulej andej, por disa maqina që kalonin njëra pas tjetrës ia prenë rrugën. Dritat e verbuan. E kur rrezet e tyre rrëshqitën rrëmbimthi, në trotuarin karshi, ajo nuk pa më njeri. Disa njerëz, që kalo-

nin me hapa tē shpejta, pēr t'i shpētuar ndonjë shiu më tē madh, e shikuan me habi, kurse Žana nuk dalloj asgjë. Vetëm pas pak ajo e ndjen veten tē lagur. Lot tē ngrohtë i rrëshqisnin nga sytë, lot tē hidhur. Me vështirësi i mbante dënesat. Fustani i gjerë muar, i ngjitur pas zhuponit, sikur lotonte bashkë me tē. Një djalë, që i kaloi pranë, u ndal; e shikoi; iku, pastaj, u ndal prapë.

— Si thua, do tē vish?... — i tha me ngadalë.

Zana as që e ktheu fare kokën. Eci me vrap, duke qarë dhe kaloi nga poliambulanca pēr nē shtëpi.

Gjithë natën nuk mbylli sy; në mëngjes u ngrit e buhavitur dhe fare pa fuqi; ra përsëri në dyshek; vështroi tavanin e nxirë, pastaj sytë i vanë te gozhda, ku varte më parë fustanin prej basme.

Fustani muar... Sa shumë kish ëndëruar pēr 'të, kurse tashti i vjen tē ngrihet e ta bëjë copa copa.

Aty nga ora dhjetë erdhi Bukua; në dorë mbante pardesynë e Zanës.

— Mirë që e vumë në një numër, se do t'i kiske larë duart prej saj... — Bukua i buzëqeshi! Zana s'fiste fare.

— Sa budallaqe që bëhesh! Nuk e sheh? Ç'e do një njeri tē tillë? Më mirë që ndodhi tashti. Ti ke mundësi...

Pastaj ajo tha diçka tjeter; qeshi.

Zana heshti. Vështroi Bukon, që flite ngadalë dhe herë e dëgjonte, herë mendonte pēr tjeter gjë.

Kish dy ditë që fustani muar rrinte varur në gozhdën prapa derës. Zana as që donte ta shih te më sy!

— Dhe mbi të gjitha më lë takim në orën pesë, te vëndi i zakonshëm. Sa i pacipë!

U nis si e dërmuar në punë. Në stacion u takua me Bukon.

— Ti s'je fare në vete, — i tha ajo. — Ehu, c'më treguan mua për atë! Ti, si duket, s'e njëh mirë; shpëtovë prej tij...

— E marr më mend, — tha ajo ngadalë.

Para se të fillonin punën Bukon e thirrën në drejtori. Vajzat e tjera uronin njëra tjetrën dhe pyesnin për festën. Vetëm Zana nuk fliste. Ajo ishte ulur pranë maqinës dhe stamponte, stamponte pa mend në kokë; as që kish dëshirë të dëgjonte se ç'thoshin. Po u hap dera më rrëmbim.

— E dini? — tha dikush plot gjësim. — E dini se gazeta shkruan, për ju, vajza, për stamplimin. Të gjitha u grumbulluan rreth saj e ajo filloj të lexojë me zë. Vajzat dëgjonin, pastaj uronin Ritën dhe dikë tjetër. Dhe se ç'thoshin e vështronin nga Zana e prapë se ç'thoshin. Kurse ajo heshte.

— Sa bukur e ka shkruar!... — Të gjitha i përsërisnin këto fjalë dhe vështronin atë. Ajo s'e ngrinte kokën. Në të dukur ngjante e qetë, megjithëse i dridheshin duart, kur vinte ampulet në stampim.

Sa bukur, ë...

Para disa ditëve, ndërsa Petriti lexonte planin e gazetës, u kujtua për inisiativën e të re-

jave të laboratorit. Hyri e doli në laborator ashtu vjedhurazi, se mos e shihte Zana dhe të nesërmen shkrojti artikullin, që qëndroi disa ditë në dosje e pastaj doli në gazetën e 3 janarit, duke bërë bujë në repartin e stampimit.

Zana s'dinte si ta përbante veten.

«Sa bukur e kish shkruar! Sa mirë fliste për shoqet e saj! Sikur t'i kishte njojur prej vjetësh. Dhe asaj i kish thënë «**mos prano të punosh natën, në asnje mënyrë mos prano!**» Petriti të ishte ky?»

Rita e shkëputi Zanën nga gjithë ky pësh-tjellim.

— Ti, Zana, ja the të gjitha këto?

Ajo u skuq, nuk foli.

— Shkruan bukur! — Rita nuk pa se si Bukua, që apo kish hyrë, ja bënte me shenjë që të heshtë. — Sa shpejt e shkroi! Duhet ta falënderojmë, vajza, dëgjoni apo jo?

Zana s'dinte ç'të thoshte. Zgjati dorën e mori gazetën. Shtrëngoi dhëmbët, që mos ta tradhëtonin lotët. Kapérceu poshtë pështymën; lexoi disa emra dhe pastaj fjalët: «punojnë në stampim». Vetëm emri i saj mungonte.

Ajo ziente e tëra. Ta kishte atë çast përrapa, do t'i ishte hedhur si përbindësh...

I nxori edhe raportin mjekësor që të mos punonte natën. Ajo rrëmbeu borsenë, nxori raportin dhe u bë gati ta griste, po një mendim i mbajti dorën.

«Ta gris? e pse? pse ta gris? Më mirë t'i tregoj sa i vlen lëkura!...»

## N JË G A B I M

1

**G**jithë njerëzit e lagjes, atë ditë, i madh e i vogël flisnin për Lenin.

— C'burrë që mori, — thosh dikush.

— Mor, ai është inxhenjer mbi inxhinjerë, — ja priste tjetri. E muhabeti zgjatej. Tregonin se para ca kohe ai kish bërë një shpikje. Dhe tashti diçka të atillë po ndërmerrte. Pastaj, nëmëronin të mirat e Petros, burrit të Lenit. Ç'nuk kish ai! Jo vetëm shtëpi të mobiluar, e rrrogë të madhe, por ai ishte dhe i vetëm; duhanin e rakinë s'e pinte, me njerëzit s'përzuhej tepër. Thoshin që së shpejti do të mbronte disertacionin e do të bëhej... ç'nuk do të bëhej!... Ndaj Leni buzëqeshte e lumtur kur i thosh e éma:

E sheh, bijë e mëmës? Të qeshi fati si s'e kiske menduar asnjë herë. E pe? Se më dëgjove mua prandaj.

Kurse Leni dëgjonte e heshte, e kredhur në enderime të bukura. Notonte mbi këto èndra e buzëdështe.

Kur la shkollën përgjysmë e nisi t'i ndihmojë s'ëmës në punët e rröbaqepsisë, ajo as që mund ta prashikonte një fat të tillë. Nga që nuk shkonte mirë me mësime, nuk i erdhì keq për shkollën, nuk i dëgjoi as këshillat e shoqeve, por

u dha tepér pas zanatit dhe búzëgeshite kur u thosh e ëma klienteve të saja:

— E kam çupë pér kokë të çupës. Vjen ora tetë dhe shtëpinë e kám dritë, pazarin të bërë dhe gjellën në zjarr. Çfarë s'i zë dora!

Klientet dëgjonin, e përgëzonin Lenin dhe e uronin. Ajo ulte kokën.

Pikërisht një nga këto kliente i foli pér Petron. Në fillim ashtu pa të keq; pastaj i tha se ai kërkonte të martohej me një vajzë të mirë, të urtë, punëtore... Leni ishte skuqur. Pastaj, kur mësoi të mirat e Petros, i hypi dëshira të cinte si ishte, dhe kur e pa ashtu të bëshëm e mjaft simpatik, dëshëroi vetëm një gjë: ta pëlgente edhe ai.

## 2.

Ajo doli nuse e bukur, e veshur me rroba të hijshme, e stolisur me zbukurime që kushtonin. Sytë i qeshnin atë ditë dhe dukeshin çuditërisht të bukur. Dhe njerëzit pér të pa'ën herë thanë: nuse të mirë ka marrë. Atë ditë... Dhe, pastaj, kjo histori sikur u harrua. Thonë që i panë dy — tri herë në lozhat e teatrove. Ditët e para të martesës. Ai lexonte programin, kurse ajo vështronë pér rrëth e kënaqur. Se ç'i kish thënë atij duke hedhur vështrimin të një llozhë tjetër. Ai e kish dëgjuar, por s'e kish kthyer kokën andej. Dhe ajo s'kish vështruar më aty. Me këtë mori fund buia e saj aty e tre vjet më parë. Tashti pér të s'kujtohej njeri. Ajo s'dëgjonte më të thoshin: c'burrë që mori. Vinte re që njerëzit kishin kokën kur dilte rrugës, dëgjonte dikë të thoshtë...

a do të buzëqeshte vallë, a duhej të buzëqeshte,  
si mundej të buzëqeshte?

Ajo se mblodhi dot veten.

Si është e mundur vallë?

Të flasë gjithë Tirana, dhe ajo... A po mos  
babai është gabuar, ndoshta flitet për ndonjë Pet-  
ro tjetër dhe ai ka kujtuar... — mendonte Leni.

Vrapoi në bibliotekë; mori gazetën, e kontro-  
lloj dhe s'u besoi syve. Një fotografi e Petros  
ish në mes të gazetës, rrëthuar nga qindra fjalë  
që flisnin për të, për vështirësitë e tij, për kërm-  
imet, për punën e palodhur... Sa shumë fjalë  
thuheshin për Petron... Dhe ai ishte burri i saj.

Ai hyri me hap të shpejtë, si pérherë, me fra-  
zën e tij:

— E, ç'bën?

Dhe s'dalloi sytë e skuqur të saj. I tha se  
goftet i kish bërë të mrekullueshme.

Ajo s'foli. Priste në heshtje, donte që mos të  
zbutej zëmërimi i saj, dëshéronte, që ai të mos  
thoshte asnjë fjalë, të heshtëte, dhe askush mos  
ta prishte këtë heshtje, që pastaj, kur të shpör-  
thente ajo, ta ndjente veten të lumtur. Ndaj, kur  
u ngrit ai e hyri në dhomën e gjumit, ajo i tele-  
fonoi s'ëmës.

— Dëgjon, pasdite nuk do të jemi në shtëpi,  
ta dish, se mos kishit ndër mënd të vinit. — Dhe  
s'priti të marrë përgjegje.

I mblodhi enët e i la pa larë. U shtri pranë  
Petros në krevat. Ai heshtëte dhe diçka mendon-  
te, kurse ajo mbante vesh qdo frymëmarrje të tij.  
Pastaj u drodh,

— Më kanë dhënë një shpërblim për punën  
që kam bërë, — i tha ai. — Paret i kam në xhep  
të pantallonave. Sikur doje të bleje diçka...

Ajo mbylli sytë; bëri sikur flinte, kurse ai u kthye nga ana tjetër dhe lëvizë dy tri herë. Pastaj u ngrit, kontrolloi në dollap në e kish këmishën të hekurosur.

— Do dalësh? — i tha ajo.

— Po, do mblidhemi në ndërmarrje. Ti po deshe shko nga nëna.

Ajo s'foli. Gjithmonë kështu do ngjiste. Ai kish mbledhje, kish shumë punë për të bërë, ish i lodhur. Dhe ajo ishte e lirë të shkonte te nëna. Ç'të bënte tjetër? Një herë, ndërsa Petrua anko-hej se kish shumë punë, se do flinte vonë atë natë, ajo i tha:

— Do të të ndihmoj Petro? Mund të të bëj ndonjë gjë?

— S'eshtë punë për ty ajo, Leni. Ku merr vesh ti! — iu përgjegj ai duke qeshur.

— Më mëso ti që të punojmë bashkë, Petro.

Ai nuk u përgjegj dhe Leni e ndjëu, se nuk kishte të drejtë ta luste për një gjë të tillë.... E me të vërtetë ku kuptonte ajo nga ato punë?

Të nesërmen, ndërsa ishte duke fshirë në dhomën e tij të punës, shfletoi dy — tre faqe nga një libër e qeshi. Kish të drejtë Petrua... E nga ta dinte ajo se ç'ishin gjithë ato x e y që kërcenin njeri mbi tjetrin? Qeshi në cast, por ndjeu dhe një dhimbje, në kraharor, e aty diku grykës. Një sëmbim të fortë. U largua me të shpejtë nga dhoma, që të shpëtonte sa më parë nga brengat që provoi. Ditët e tjera ajo e pastron-te shpejt e shpejt dhomën, hiqte pluhurin nga tavolina, nga librat e stivuara e nuk guxonte të hapte asnjë faqe. Brengat e pushtonte sérish. Ajo e shtyu të mendonte se duhej gjetur një punë, se

duhej filluar një jetë e re, që pastaj edhe Petrua tē fliste me të pér X e Y. «Pa tjetër kështu duhej vepruar», mendonitë ajo.

Dhe tashti, që ajo rrinte shtrirë në krevat dhe heshtëte, vriste mëndjen tē gjente çfarë mendonte ai pér të. Po, si duket, ai as që mendonte gjë; ai as që kish ndonjë ankim e as ndonjë kërkesë; ai ish i kënaqur nga Leni, kurse pakënaqësia e saj as që kish vlerë pér të.

#### 4.

Kur u ngrit ajo nga shtrati dielli po shpejtonte tē fshihej prapa kôdrës përballë dritares, dhe fletët e plepit lëkundeshin nga një erë e lehtë.

Pasqyra e trëmbi. Ishte zbehur në fytyrë. Sytë i qenë skuqur. Flokët kishin mbetur pa krehur.

U dëgjua zilja e telefonit, por ajo nuk e mori receptorin.

E pse ta marrë? As që i pëlqen tē bisedojë me njeri.

U vesh me tē shpejtë, u rregullua para pasqyrës, duke u munduar tē zhdukte gjurmat e shqetësimit dhe doli në rrugë. Po ku tē shkonte? Gjithë Tirana fliste pér të. Të gjithë kujtonin se ajo festonte ngjarjen e madhe në shtëpinë e saj e gjetiu bashkë me burrin... U sorrullat pér një kohë tē gjatë dyqaneve, rrugëve tē ndryshme, qëndroi pranë vitrinave e para reklamave; më në fund ngjiti me rrëmbim shkallët e një pallati, i ra ziles e mëzi priti tē hapej dera.

— Leni, c'ka ngjarë?

S'ëmës i râ pjata nga duart dhe iu çakëritën sytë nga tronditja. Kurse Leni s'pushonte e s'pu-

shonte. Ngashërimet po e mbytnin. E ëma i hodhi një gotë me ujë në fytyrë dhe e shtriu në divan.

— Më thuaj, ç'ke. — përsëriste ajo pa pushim, pa ditur si t'i ndihmojë së bijës, që e zuri kjo krizë e paparë.

— Asgjë, — tha ngadalë e disi e lehtësuar nga ajo gotë uji, që i hodhi e ëma. — Kot... se si më erdhi.

— Të të bëj një kafe?

— S'dua gjë, — Leni ndjeu lotët t'i rriddhni nëpër faqe; e zuri të ëmën nga dora: — Dëgjo, mos i thuaj babait. Kushedi ç'do të kujtojë.

E ëma sikur e mblođhi pâk veten.

— Ku ishe? Nga mbrëmja vjen?

Leni s'foli.

— U takove me Petron dhe me babanë?

— Jo. Pse?

Dhe ajo i tregoi se Petrua e kish kërkuar kushedi sa herë në telefon. Kishte mbrëmje në ndërmarrje dhe të gjithë shokët e tij do të venin me gra.

— Ku ishe futur? — vazhdoi e ëma. — Unë për ty po mendoja... Thashë, kushedi, kërcen tashti... Po bëja një embëlsirë. Mendova se do kthehet këtu pëq mbrëmjes.. Kurse ti..

Leni e vështronë pa e pasur mëndjen te fjalët që thosh ajo.

E ëma iu ul pranë.

— Si qëndron puna? Mos jeni zenë?

— Jo, mëmë.

— Po çfarë?

— Unë ruk kthehem më tek ai.

— Si?

Asaj iu err botë.

— Je në yete? — i foli ashpër së bijës dhe e shkundi me tërë fuqinë. Po sytë e Lenit vështronin po me atë mospërfilljen e mëparshëme; nuk jepnin asnjë shenjë, asnjë përgjegje. E éma u egërsua.

— Ç'të gjeti, moj bijë? — filloj ajo me zë të ngashëryer... — Bota të ka zili, kurse ti i bije së mirës, me këmbë. Mendon apo jo? Të gjithë, të kanë zili.

— Ata gabojnë, mëmë... Edhe ti gabon... Edhe unë gabova... — Ajo u ngrit që të përbante ngashërimet.

E éma u shastis fare. Dhe kish të drejtë, Giithë pasditen kish flutuar, nga gjëzimi. Kujt s'ja kish thënë këtë gjësim, kujt s'i ish mburrur pér dhëndërin... Kurse ajo, vetë Leni, thoshte se nuk kthehet më tek ai. Po ky turp?

E shtriu përsëri të bijën dhe filloj t'i férkojë dorën.

— Mblidhe veten të keqen nëna, — i thosh herë pas here, Por Leni s'e dëgjonte.

Por Leni, që e bëjë kurrë, nuk e dëgjonte. Nuk e dëgjonte që këtë gjëzim është një gjëzim i vërtetë, që këtë gjëzim është një gjëzim i vërtetë.

— Nuk e dëgjonte që këtë gjëzim është një gjëzim i vërtetë, që këtë gjëzim është një gjëzim i vërtetë.

Por Leni, që e bëjë kurrë, nuk e dëgjonte. Nuk e dëgjonte që këtë gjëzim është një gjëzim i vërtetë, që këtë gjëzim është një gjëzim i vërtetë.

Por Leni, që e bëjë kurrë, nuk e dëgjonte. Nuk e dëgjonte që këtë gjëzim është një gjëzim i vërtetë, që këtë gjëzim është një gjëzim i vërtetë.

Por Leni, që e bëjë kurrë, nuk e dëgjonte. Nuk e dëgjonte që këtë gjëzim është një gjëzim i vërtetë, që këtë gjëzim është një gjëzim i vërtetë.

Por Leni, që e bëjë kurrë, nuk e dëgjonte. Nuk e dëgjonte që këtë gjëzim është një gjëzim i vërtetë, që këtë gjëzim është një gjëzim i vërtetë.

## TROKITJE NË DERË

Më parë, kur ende shetiste në bulevardin e Tiranës, ajoëndëronte jetën e re që do të niste, e i dukej e bukur dhe pa asnje telash, kur parafytyronte veten veshur me përparëse të bardhë, apo duke fuguar në ndonjë monopat përfshirët shpëtuar dikë. Kish provuar përmes endrave të saj gjëzimin që ndjen kushdo, kur del faqebardhë dhe as që i kishte dhene rëndësi në qoftë se andej e tutje do të ishte midis njerëzve të huaj, në një vend fare të panjohur. Kështu enderonte ajo më parë. Pastaj... ditët me radhë sollën njera tjetrën, ngjarjet, si të thuash, rodhën vetiu e në një mëngjes plot mijergull, kur Didi mori rrugën e trenit e në stacionin mbushur deng, midis qindra njerëzve nuk dalloj asnjë të njojur, ajo ndjeu shqetësim e përfshirët parët herë një pasiguri në yeten e saj.

Ku shkonte vallë? C'njerëz do të takonte?

Zëri i mallëngjyer i nënës e pruri në vete.

— Dëgjon, Didi? Të kesh mendjen, të keqen nëna.

Ajo, mbështetur te dera e hekurt e stacionit, dëgjonte dhe s'dëgjonte; yeshtrimin e hidhëtë sa nga një grup te tjetri i turmës pranë.

Fundja dhe nië të njojur të largët të kem në këtë rrugë të shkurtër, mendonte me vete.

— Dëgjon, Didi?

Ajo buzëqeshi duke u munduar ta flakte tej hien e shqetësimit që posa iu çfaq.

— Po, po, nëno!..

Kur u nis treni, ajo qëndroi pranë dritares së një vagoni e që andej kundronte kodrinat e gjelbëruara, shtëpitë e lyera me gëlqere që aty dukeshin e aty zhdukeshin, udhëzat e ngushta dredharake.

Si do të jetë fshati ku do të shkojë ajo? Rrëzë kodrës vallë? Ja, për disa minuta do të zgresë shkallët e vagonit, do marrë një rrugë, nëpër të cilën s'ka shkelur asnje herë. Në baltën e saj do lerë gjurmën e parë të çizmeve me takë... Pastaj... As vetë s'e dinte çdo ndodhje më vonë... Vetëm një gjë kishte të sigurtë: do veshte përparësen e bardhë, do shkruante receta.

Sirena vërvhëlleu e, fill pas kësaj, treni ngadalësoi vrapin. Didi kapi dorezën e hekurt të valixhes dhe u drejtua nga dera.

— Me kujdes, shoqe, — i tha dikush.

Ajo ngadalësoi hapat, priti sa u ulën poشتë të tjerët e pas tyre zbriti shkallët. Si e hutuar bëri hapin e parë në stacionin që andej e tutje do të bëhej i saj.

Ku të shkonte! Si të paraqitej?

Qëndroi në strehën e një barake. Treni përsëri uluriti dhe u fshëh matanë kodrës. Kur humbi midis reve të bardha dhe shtullunga e fundit e tymit që volli lokomotiva, Didi ndjeu një zbrazësirë, sikur ti ish shkëputur diçka e dashtrur, e shtrenjtë.

Njerëzit që kishin zbritur me të kishin marrë të përpjetën. Dhe ata s'bëhetin as 8-9 veta.

C'të bente ajo? Cilën rrugë të merrte?

Në barakën pranë u dëgjua një zë bas. Se kush kendonte «Për midis pazarit Durrësit».

Didi, duke mbajtur valixhen e rendë me një dorë, me tjetrën trokiti lehtë. Përgjegje s'pati. Ajo priti e kur mbaroi kenga, i ra derës më me forcë. Një burrë që i hapi derën e shikoi me kërshtëri.

— Më falni... Ju lutem... Po... — iu ngatërruan fjalët.

Ai i qepi sytë.

— Çfarë? Mos ju la treni? — dhe buzëqeshi.

— Jo, jo. Dua të di ku është drejtoria e fermës suaj.

— Drejtoria?

Ai e veshtroi që nga koka të këmbët.

— Ju jeni arësimtarja e re?

— Jo. Unë jam mjeke.

Didi buzëqeshi, kurse sportelisti kureshtar hapi sytë fort.

— Mjeke!...

— Sapo mbarova shkollën, — tha ajo nga dalë.

— Duket... — tha ai thatë. — Ja, ajo shtëpia e bardhë, në mes të atyre tri të tjerave. Aty shkon. Besoj se drejtorin do ta gjeni në zyrë.

— Ju falem nderit.

Didi mezi e ngjiti të përpjetën. Gishtrinjtë e butë iu dërmuan nga doreza e ftohtë, kurse në kraharor ndjeu një drithërimë. Ju bë sikur iu zu fryma. E kish pushtuar një ndjenjë ngurrimi e frike.

Si i rregulloi plackat, për një kohë të gjatë

qëndroi te dritarja më tepër për t'u përqëndruar në mendime së sa pér të soditur vendin rrëth e qark. Këtë punë e kish bërë pak më parë, kur në ballkonin e ndërtuesës njëkatshe e zonja e shtëpisë e kish gostitur me kafe. Që prej andej gjysma e fshatit dukej si në pëllëmbë të dorës. Shtëpitë e vogla të ndërtuara njera më poshtë se tjetra kishin zënë të dy anët e rrugicës gjarpëroshe, kurse fletët e verdha të pemëve rrëth e qark sikur pëshpërisnin diçka të fshehtë. Frynte pak erë.

Mund të na sjellë shi, — i tha plaka. Simvjet na mbyti balta.

Didi, e ndrojtur, iu përgjegj se kështu e ka vjeshta. Nuk i tha plakës se gjithmonë i kish pëlqyer një kohë e tillë: me erë të freskët e gjethë që fëshfërijnë. Ndoshata dhe me shi. Dhoma, ku do të rrinte këtej e tutje ishte e pastër. Kish dy krevatë të rregulluar, një tavolinë të vogël me një mbulesë të bardhë e një dollap me tel. Në oxhakun te muri, përballë derës, ku akoma tymoste një dru, varur në një çengel nga lart, ish venë një gjym.

— Ja, ky është vendi yt, — i tha gruaja dhe iku.

Didi mbeti vetëm me valixhe në dorë e me mendimet e saj.

Shumë vonë, aty nga dreka, kur ajo, e lодhur, kish mbështetur kokën te hékuri i krevatit, u hap dera, në dhomë hyri një vajzë e qeshur me dy gërshtetë të zeza.

— Jam Lumja, mamia, — tha. — Më prisnit aro jo? — Didi i zgjati dorën e desh ta përcafonte. Ju duk se ajo ishte njeriu më i deshëruar i saj në atë çast. Sikur jú shmpi trupi.

sikur iu zgjidh goja, dhe ajo, e qeshur, ç'nuk foli me të. Pastaj i ranë fshatit anë e mbanë e mbrëmanet, të lodhura, por të kënaqura, u shtrinë në krevatët e tyre.

— Fshati është i vogël, por i bukur. Dhe një gjë më pëlqen: që është i përbledhur. Sa shtëpi bëhen gjithësejt?

Lumja që nga krevati tjetër përgjigjej me qejf.

— Po mjeku i parë si ishte? Ç'thoshin fshatarët? — Lumja heshti. Sikur s'donte të fliste; pastaj i tha se më të shumtën e rasteve ai rrinte në Tiranë, bëri dhe ca gabime e kështu humbi besimin e fshatarëve.

Didit i theri në zemër:

Po ajo ç'do të bente? Çdo thoshin ata njerëz pér të?

— Ai s'e kish mendjen këtu — vazhdoi Lumja. — Pastaj, kush do të punojë si duhet, s'e ka të lehtë. Duhet të durosh shumë ndoshta dhe të luftosh deri sa t'ja arrish qëllimit.

E ndërsa ajo vazhdoi të flasë pér mësueset e fshatit, pér agronomin, Didi mendonte me frikë të nesërmen, vizitën e parë.

Të nesërmen, kur u drejtua pér në ambulancë, pa sosur mirë, vuri re se po e prisnin. Një burrë zëshkan kish lidhur kokën me një copë të bardhë; një grua mbante në duar një fëmijë të mbështjellë, kurse një plakë ishte ulur te dera e ambulancës.

— Mirë mëngjesi! — përshëndeti Didi.

Ata iu përgjegjën njëherësh:

— Prisni këtun I. pari të vijë fëmija, — tha ajo dhe hodhi vështrimin tek të tjerët.

Ata nuk folën. Fëmija - u 'kollit, në fillim

lehtë, pastaj kolla iu bë halë. Ai çirrej e mundohej nën rrabet e trasha. Nëna e mbështollë më tepër dhe shkoi pas mjekes.

— Zvishe, — i tha Didi.

— Doktoreshë, ti ë dëgjove. Ja, kollë ka. As zjarr, as gjë. Vetëm kollë.

— Sidoqoftë, zvishe, — i tha Didi. — Unë duhet ta shikoj.

— Pse, doktoreshë? Shkruaj ca gjilpëra e mbaroi. Ato bëjnë punë për çdo gjë.

Didi s'u përgjegj. Mori stetoskopin e u drejtua nga fëmija.

— Hiqja të gjitha.

Nëna u bind e s'foli më, e ndërsa Didi shfletonte kartelën ajo zveshi djalin tërë hundë e buzë. As kur i tha Didi se ç'kish fëmija, s'nxori ze fare, as kur mori recetën prej dorës së saj. E veshi shpejt e shpejt e doli jashtë.

— Tjetri, — thirri Didi.

E kështu duke vizituar, duke shfletuar kartela e shkruar receta, iku dita e parë e saj në punë.

\* \* \*

Po s'kaloi asnjë javë, kur një pasdite asaj i hyri dyshimi se diçka nuk ishte në rregull. Në ambulancë nuk po dukej njeri. Ky tersllék i kish ardhur që nga ajo ditë, kur ish zënë me atë punëtorin që i dhimbte dora, e që ishte zënë me të drejtë. Ai kish hyrë shumë qetë në ambulancë, ish ulur në kolitukun kundrejt mjekes e kish shqiptuar emrin e tij.

— Çfarë keni? — e kish pyetur ajo.

— Ja, dora! — dhe e kish zgjidhur nga-

dalë, duke rrudhur fytyrën sikur po lëndonte ndonjë plagë të rëndë.

— Ju qenka shëruar, — i kish thënë Didi e gëzuar. — Mund ta mbani zgjidhür sot. Ja po i vemë... — Dhe kish heshtur. I sëmuri e kish vështruar me körcënim.

— Kanë prurë këtu një kalama, — kish thënë ai ashpër. S'tha më kot ajo gruaja që ditën e parë...

Didi ish dredhur e tëra. Ja kish mbërthyer svtë e hirta atij e s'kish folur.

— Mua më dhemb, më ther krahu, e ti... Unë s'mund ta lëviz dot, e ti...

— Hajd ta mjekoj dhe ta lidh, me që keqejf.

— Unë dua raport, s'punoj dot.

Sytë e hirtë të Didit përsëri ishin mbërthyer në fytyrën e tij. «Këtu qenka halli!» — kish menduar ajo dhe s'e kish përbajturi dot veten. e kish vështruar rreptë në mënyrë kërgënonjëse.

— Tjetri! — kish thirrur me sa zë, që kish si mbaroi mjekimin.

Por i sëmuri s'kish lëvizur që andej; kish qëndruar i ngrysur para 'saj.

— Rarortin, doktoreshë.

— Ju mund të punoni. Jeni në rregull, — i kish thënë ajo me ton të prerë.

Ai se c'kish mürmuritur nepër dhëmbë e kish përplasur derën me forcë.

— Tjetri! — kish thirrur Didi përsëri me zërin e saj të hollë.

Por dera nuk ishte hapur. Ai kish pritur në heshtie. Pastaj kish dalë jashtë. Njerëzit ishin shpërndarë.

Dhe fjalët kishin marrë dhenë.  
Kështu kishte ndodhur. Por kjo pati pasojja të këqia. Të sëmuret ishin paksuar e pothuajse prej dy ditësh ata kishin ardhur përmjekime të vogla.

«Ndoshta s'ka të sëmure» — ish munduar ta qetsonte ajo veten. «Sa e keqe që bëhem... E pse dua të sëmure? Aq më mirë në rast se s'ka.»

Porse në mbrëmje atë sërisht e kish pllakonsur hidhërimi.

— Tek ju nuk sëmuren kollaj njerëzit, — i kish thënë ajo Lumes, gjoja ashtu kot, por, q'ish e vërteta, kish pritur me ankth përgjegjen e saj. Ajo do ta çlironte nga dyshimi i tmershëm.

Lumja e kish vështruar drejtë në sy. Pastaj kish folur.

— Do të ta thosha dhe vetë, por, meqë më pyete, dije; njerëzit shkojnë në Tiranë për tu vizitar.

— Pse?

Pastaj ajo ish kthyer nga dritarja, përtë fshehur lotët që i shpëtuan.

\* \* \*

Herët në mëngjes, si doli nga shtëpia, nuk mori rrugën për në ambulancë, por u nis drejt lagjes së sipërme. Te çezma nën rrapi e madh, disa vajza kishin përveshur llërët, Janin duart e fytyrën e flisnin me zë të lartë: Didi u kaloi pranë, i përshëndeti e vazhdoi rrugën. Pastaj u kthye e pyeti:

— A ka ndonjë të sëmure këtej?

Vajzat shikuani njera tjatren, pastaj Di-

din, që s'lëvizte nga vendi e priste përgjigjen e tyre.

— Çfarë, fëmije? — tha njera.

— Fëmijë, plaka, gra...

— Plaka? Ja, nënë Limja ka tre muaj shtrirë.

Vajzat thanë edhe disa emra të tjerë, i treguan shtëpitë e tyre dhe važhduan të lahen.

Didi ngjiti të përpjetën, iu afroa shtëpisë së parë e trokiti në derë.

Një grua e re me një fëmijë të vogël në duar i doli përpara.

— Urdhëroni — e ftoi.

Didi buzëqeshi:

— Më thanë se e kini fëmijën pa qejf. Desha ta shikoj. Ç'ka?

— I kishin dalë ca puçrra. Tani është më mirë. Na e ka parë doktori në Tiranë.

Didi u zverdh, por menjëherë e përblo-dhi veten.

— Por... Ta shoh si i ka tani...

Nëna i zbuloi kofshët fëmijës.

— Po... megjithatë, silleni mbasdite në ambulancë ta mijekojmë.

— Mirë — tha e reja nëpër buzë.

Didi pshëretiu dhe vazhdoi të përpjetën.

Kaloi një ditë, dy, e ajo bridhte nga një shtëpi në tjetrën e pastaj kthehej në ambulancë e lodhur, pa qejf e plot shqetësim se sidonente halli i saj. Një pasdite, teksa mendonte se ç'duhej të bënte, trokitën në derë me rrëmbim.

Ajo u ngrit e trëmbur dhe pa në praktik një grua që mezi merrte frymë.

— Doktoreshë!...

Ishte tepër e tronditür.

— Çfarë ke? Folë!

Didi ndjeu t'i rrjhte zemra fort.

— Lumja! A erdhi Lumja, doktoreshë?

Didi e pa veten të dobët, të pazonjën për ta ndihmuar këtë njeri.

— Lumja? — pyeti ajo si pa kuptim. Vështroi si e hutuar gruan e heshti.

— E shkreta unë, ç'të bëj? — thirri tjetra dhe sakaq u zhduk. Didi vrapi pas saj.

— Pse? Ç'ka? Ajo është në Gurë.

Dëgjoi një rrënkim të mbytur:

— Na iku nusja e shkretë... Askush s'i bën dot gjë.

— Si?

Përgjegje s'pati.

Didi me ndroje e pa siguri i thirri gruas që të ndalej.

— Ika, s'pret puna! — dëgjoi si përgjegje.

Megjithëse e pavendosur në atë që do të kryente, ajo mori guximin dhe e pyeti se ku e kishin shtëpinë.

Por gruaja s'e ktheu kokën, u fut në një derickë aty pranë e iu përgjegj me shqetësim grave në oborr.

Për një çast Didi dalloi se atë po e vështronin. Priti ta thërrisin, porse ngjau diçka që i shtoi pasigurinë që po provonte: një grua tundi krahët në shenjë mospëlqimi e s'u desh as një sekondë që të tjerat t'i kthenin krahët mjekes. Sedra e fyer i dha këmbë Didit e sakaq ajo u gjend te dericëka.

Por përsëri aty u hutua, ngadalësoi hapat dhe hieja e shqetësimit e pushtoi.

A do të mundëtë vallë: ç'dinte ajo shumë shumë, pér zanatin e mamiçë? Sikur asgjë s'i kujtohej. Lindja... Po çfarë kishin mësuar në teknikum pér lindjen?

Këmbët e çuan në koridorin, ku qëndronin disa gra e thuajse përgjonin pranë derës në të djathtë.

Pa pyetur çau nëmes tyre e u gjend në një dhomë të madhe, në cepin e së cilës, mbi një rrugoz, epej e mundohej një nuse e re. Plaka që qëndronte te koka e dy gra që e fërkonin kush duart e kush belin e ndalën pér një çast vështrimin mbi Didin dhe u ngrysën në fytyrë.

— S' është punë pér ty kjo, moj bijë. Ti sa ke zbritur nga djepi.

Didi bëri sikur s'dëgjoi. Iu avit nuses, i mati pulsin e u shqetësua. Nusja i mbylli sytë që deri atëhere i kish të çapëluara, kurse kokët e vari fare.

— Ka shumë kohë në këtë gjëndje?

Askush, s'u përgjegj.

Plaka me monotonitë padurueshme përsërise:

— Shtrëngohu, shtrëngohu, nuse... e u bënte me shenjë të rejave që ta binin në vete. Atëhere ato i shtrëngonin fort damarët nën qafë e nusja përsëri i çapëlente sytë që i kishin thelluar.

— Ká shumë kohë?... — ju drejtua mjejkia së resë që sapo selli ujë. E priti me ankth. Ndërsa e reja tregonte, së gruas i kishin filluar dhimbjet që në mesnatë, se në mëngjes kishin kërkuar disa herë maminë e nuk e kishin gjetur dhe së tanë ajo s'fiste fare, Didi

që mundohej mos t'i shpëtonte asnje fjalë njëko-hësht vriste mendjen se ç'duhej të bënte.

U ngrit e as vetë s'e kuptoi si arriti te de-ra e konsultores. I provoi çelësat që kish me vete e kur e pa se ishte e kotë të qëndronte aty, i dha një të shtyrë dritares. Disa njerëz pranë, të trëmbur nga zhurma e xhamit të thver, qëndruan si të shastisur, por Didi s'e kish mendjen tek ata.

«A mora vallë gjithçka?» tha me vete.  
E pasigurtë, ajo qëndroi pranë dritares me një legen të vogël, në fundin e të cilit kish vë-në disa vegla.

«Besoj se në rregull». - i dha kurajo vetes e u mat të dilte sërish nga dritarja, por i doli vërvëra ftyra e zbetë e lehonës me sy të çakëritur, pastai të mbyllur.

«Gjendje shoku... shoku... Po çfarë duhej të bënte», mendonte ajo.

Metrazol, kafeinë — sikur kish parë një rast të tillë në praktikë... Po çfarë i bënë?... Cfarë i bëri profesori gruas? Jo, s'i kujtohej. Dhe Lumia sikur i kish treguar një rast tanë afër.

Me sy të ngulitura të mbulesa e tavolinës, sikur atje të ishte shkruar zgjidhja, ajo mundohej të kapej pas saj.

«Metrazol... kafeinë, kamfor.. Hiç të mos kem frikë. Tamam ashtu është» i dha kurajo vetes.

«Pastaj pituitrin, ergotinë, lobelinë pér fëmi-jën. Si e harroi ajo!... Pse u hutua këshku!

Me një besim të çuditshëm që lindi aty pér aty u nis pér në shtëpinë e fqinjës.

Por në gjysmën e rrugës u kthyesh përséri:  
kish harruar stetoskopin.

Lehonën e gjeti më keq.

— Ngreuni, dilni jashtë. Pregatitni ujë  
të ngrohet. Me mua do rrijë vetëm e reja.  
Plaka s'desh të dëgjonte.

— Kjo është puna ime — i thirri ajo Didit.

— E ti s'duhesh këtu.

Didi i bëri me shenjë grave që të merrnin  
plakën e të iknin, por ato ngurruan.

— E po ikëni, de! — thirri ajo me të marr-  
dhe e u çudit vetë për ashpersinë që tregoi.

E shtriu lehonën, e vizitoi. Ish gati për  
lindje, pór stetoskopi i ngjallti dyshim. Të rrash-  
hurat e zemrës së foshnjës ishin tëpër të dobëta.

Si t'ia bënte? Po sikur... mendonte

— Nuse, xhan! Mblidhe veten! C'bebe të  
bukur që po lind!

Aty për aty i bëri një ozmon dhe një vi-  
taminë C.

— Edhe pak. Ja... kujdes, nuse.

Fëmija lindi i nxirë, nuk qau. Pulsi nuk  
i ndihej.

— Përséri të vdekur, e shkreta! bëlbëzoi  
dikush.

Didi mësoi se para tre vjetëve lehonë kish  
lindur femijë të vdekur. I hyri dyshimi që e  
hidhëroi pa masë.

— Po s'dihet — tha ajo me zë.

— Ujë, nuse, ujë të ngrohtë e të ftohtë.  
Të vijë dhe dikush tjeter këtu.

Por as uji, as metrazoli as lobelina nuk bë-  
në punë. Shtë i vajtën të goja e fëmijës, nga ku  
dilnin ca jarga. Iu kujtua një rast që i kish

ndodhur Lumies para ca ditësh. Nga që fëmija kish ndenjur shumë kohë në bark; kish thithur mjaft lëngje.

— Në qytet ka aparat të posaçëm — i kish thënë Lumja, — kurse ne duhet ta shpëtojmë fëmijën duke thithur me gojë këto lëngje — thith e derdh, thith e derdh.

Kështu bëri tani Didi.

Kur nuk mbeti më gjë për t'u nxjerrë, ajo filloi frymëmarrjen artificiale e atëhere sa s'qau nga gëzimi. Fëmija u çel në fytyrë, nxori një zë të mekur, pastaj më të fortë sa që u dëgjuat prapa derës. Gratë që përgjonin s'pri-tën më, por u turrën brënda.

— T' ju rrojë djali!

Didi qështe si fëmijë. Por... ngriu në vend. Lehona dukej e vdekur. Didi sa s'u çmend. E pastroi fëmijën, e mbështolli shpejt e shpejt, e u — muar me gruan.

Ajo kish mjaft hemoragji.

Filluan përsëri injeksionet, pecet me ujë të ftohtë, masazhet.

— Nuk i pushon, doktoreshë. Të thërrasim doktorin e Shijakut? Ta nisim për Tiranë?

Ajo u hutua, megjithatë mundohej t'i qetë-sonte gratë.

— Mos u shqetësoni. Tani do të bëhet më mirë.

E përsëri ozmone. E. përsëri dyshime.

«A do t'i pushojë?» mendonte.

Mos duhej bërë diçka tjeter?», vriste, ajo mendjen:

Gruaja sikur i çeli sytë, por përsëri i mbylli.  
— Do t'i pushojë, do t'i pushojë. Vérini  
pece, bëni masazh.

Gratë ndiqnin çdo lëvizje të saj sikur nga  
ato të varej shpëtimi i lehonës.

— E shihni, është më mirë... Si thua. Fa-  
time? Dëgjon?

Lehana u mundua të ngrerë kapakët e sy-  
ve, por ata ranë të pabindur. Vetëm vuri bu-  
zën në gaz.

— Sa çun të bukur që ke lindur! Didi i  
fërkoi krahun.

Një drithërimë përshkoi lehonën. Dy pikat  
loti rrëshqitën në faqe, kurse dora pa fuqi  
shtrëngoi llërën e Didit.

— Tashti ta nisim për Tiranë — tha tajo.  
Gruaja ka nevojë për gjak.

## KUR BINTE SHI

**M**aqina ecte fluturim në rrugën që gjarpë ronte, duke iu ngjitur kodrës. Njerëzit, të ulur mbi disa thasë, ishin struktur e mbledhur për t'u ruajtur nga valët e fuqishme të erës, që u përplaseshin mbi fytyra e në gjokse. Vetëm Liza s'donte t'ja dinte fare. Flokët e zes kaçurrelë i valviteshin lirshëm. Sytë veshtronin plot gaz. Hera — herës ajo levizte dorën ngadalë, e vinte pranë kraharorit, aty të xhepi i brendshëm i jelekut dhe e ngjishte pas zemrës sendin që prekte me të. Atëhere sytë e saj merrnin një shkëlqim maqnitésh, thua jse në thellësi të tyre shuhev e ndizej një dritë lozanjare.

«Ja dhe dëshira e saj. . . E pranuan. . . Po sa mirë folën shokët për të...» — mendonte Liza.

Ktheu kokën nga shokët, e menjëherë vështrimin e uli mbi thasët, se sytë e Lekës i bënë priti. Ai i qendronte aq pranë... Dhe e veshtronte. . . Si e veshtronte ai. . . Një e rrënqethur i përshkoi trupin, ndërsa në zemër u rrit një shpresë, që sa kish mbirë.

Dikush ja mori një këngë e, pastaj, kengë të shumta ndoqën tjetrën. Ajo hodhi vështrimin larg, atje ku puthej qelli me tokën, mbërttheu trikon deri në grykë, ngriti çorapet e trasha e të pambukta e u bashkua me zërin e shokëve.

— Do të ketë shi, — tha dikush. — Shihni si gjemon nga jugu.

— Shi?

Ajo buzëqeshi.

— Le të bjerë... Mua më pëlqen kur bije shi e fryn erë.

Një re e zezë vraponte në drejtim të tyre.

— Megjithatë është më i bukur moti me diell — tha Leka mendueshëm. Liza veshtroi nga thepat që ngriheshin lart e u mundua më kot të gjente vendin ku puthej qelli me tokën.

Një shi i lehtë filloi të bjerë. Vranësia pushtoi hapësirën përqark. Maqina u ndal të një përrua, në të dalë të kooperativës. Njerëzit zbritten, u përshëndetën dhe u ndanë.

— Liza, prit të të përcjellim, — i tha dëkush. — Pasnesër do mbledhim gjithë të rinjtë, do ta festojmë këtë ngjarje. Je e paravajzë tek ne.

Ajo ktheu kokën.

— Urdhëroni në shtëpi. Bukë e krypë e zemër të mirë.

— Nesër, bijë. Po prit të të përcjellim.

Xha Martini u nis drejt saj. Veshtrimi gazmori vajzës humbi në enësirën e natës.

— Më kanë rritur këto bjeshkë, i xha Martin. Nuk kam frikë. Ja, një copë rrugë idom të jem bashkë me Lekën.

Rriuga merrte frezë kodrës, pastaj ngjitej lart, zbriste e përsëri ngjitej. Pranë shtëpisë së Lékës ajo u ndal në para. Veshtroi djaloshin në sy:

— Mirë u pafshim, Lekë.

— Prit, prit, Lizë. Shih si u veti! Shkojmë bashkë... Vajza e shikoi me keqardhje,

— Jo, Lekë! — dhe mori rrugën!

— Dëgjo, Lizë!

Leka s'priti më. I zuri krahun, ja shterngoi fort dhe i kërkoi sytë, që ishin fshehur nën qerpikët e gjatë.

— Çfarë?

Ajo ktheu kokën menjanë, Në një pellg, nën dritën e një vetëtime, pa se pikat e shiut po dendësoheshin.

— Do iki, shiko, po gjëmon...

— Lizë... unë...

Ajo u shkëput nga duart e tij e vrapoi poshtë, në mes ferrash e drurësh të njomë. — Do të bijesh!... Ngadalë!... — dëgjoi nga pas zërin e trashë të Lekës, por s'u ndal, s'donte t'ja dinte fare. Aty në të zbritur desh rrëshqiti, u mbajt pas degës së një peme dhe qendroi të përmblidhë veten. Cullufet mbi ballë i kullo-nin. Zemra i rrihte fort, fort. Në krah ndjente akoma prekjen e Lekës, kurse në buzë një gudu-lisje të embël.

\* \* \*

Leka mbeti i shastisur pranë gardhit të shtë-pisë. S'e ndjente as shiun që binte. Errësira sikur pllakosi menjëherë e atij iu zhduk nga sytë Liza që pak më parë rrëshqiste si hie në mes kaçubeve.

«Ta kisha përcjellë... Sikur të bjerë?... U hutova si një tutkun» u bë pishman ai.

Bëri të zbriste poshtë, por përballë i doli nëna me çomangë në dorë. Mbi kokë kish hedhur një copë mushama.

— U laga, mor bir, dhë dhitë s'i gjeta... Na ikën të shkretat... E ku t'i kërkoj?

— Do jenë trembur nga gjëmimet, nënë. Pa do vinë, mos u merakos.

Ktheu serish kokën nga shtëpi. Lizës e shkoi pas plakës.

«Ajo pa tjetër ka sosur tashti... — mendoi ai i qetësuar.

Pranë oxhakut, nga ndriçonte një llampë me vajguri, atij ju çfaq profili i saj, pastaj dy sy ngazëllonjës e një buzëqeshje e ndrojtur. E pushtuan mendime, shpresa e pshëretiu.

— Ç'ke, ta marrtë nëna.

Leka e shkoi me dashuri.

— Kot, fare kot, nënë.

Plaka veshtroi si me dyshim nga ana e tij, por s'ja zgjati. E atëhere ai u ngrit, e shterngoi me krahët e tij të fortë dhe e pyeti:

— A të pelqen Liza, nënë?

— Liza Prena?

Në çast ajo ngurroi. Pastaj buzëqeshi.

— E bukur është, o bir, mbi shoqet në punë, Vec... tamam si burrë duket. Flet e s'i leviz syri... në mbledhje me burra vete deri vonë natën.

— Dhe unë vete në mbledhje, nënë.

Në dritën plot naze të llampës, që aty zbehej, aty shkëlqente, nëna nuk e dalloi zbehtësinë që pushtoi djalin; megjithatë u ndal si e gozhduar. Zëri i Lekës e rrënqethi.

— Atë e thë ashtu kot nëna, biro... Një lloj si burrat janë vashat sot. Ajo është si drita. Dhe pa të birin të qeshej si femijë.

— Qe nesër, nënë; do shkoj ta kërkoj... Ajo pa tjetër.

Dhe përsëri iu çfaq Liza e ëmbël, e bukur.

Tre të shtena njera pas tjetrës, që erdhën jo nga larg, i drodhen zemrën.

«C'të jetë?» — mendoi ai.

Dikush ulëriti. U dëgjuan ca zëra. Ai rrëmbeu fenerin, pushkën te muri e u bashkua me fshatarët e tjerë të armatosur.

\* \* \*

Ndërsa Liza me cullufe të lagura qendronte një pemë dhe ndjente akoma ëmbëlsinë e dorës së Lekës, një vetëtimë që ra pranë, e beri të tmërohet. E tronditur, u sul në anën tjetër, kukish më pak dru gështenjë. Dikush i kish thënë se ato ndjellin vetëtimat. Kështu rruga binte më gjatë, ajo do lagej më tepër, por fundja në shtëpi do shkonte. Aty e priste nëna. Ajo pa tjetër do kish ndezur zjarr të madhi.

Kur doli sërish në monopat e do kthehej në rrugicën e saj, sa s'i ngriu gjakù. Që nga kacuba pranë u ngrit një hie e zezë, mbuluar këmbë e kokë me pelerinë mushamaje. Në duar mbante diçka. Dru apo armë, s'e kuptoje.

— Ndal. S'ke ku shkon.

E menjëherë si fantazmë përpëra saj qëndroi dikush.

— E, Liza, si të kam? — foli ai si me permim.

Ajo ja qepi sytë atij, s'foli, por ndroi rrugë... Ku e kish parë atë fytyrë të vrejtur? Ç'kish ndërmend të bënte ai? Çfarë i kish bërë ajo atij?... Dyshime e mendime të errëta, thua jse po e mbysnin fare, por ajo s'e lëshoi veten; shkoi pa ndroje paratifik.

— Ha, ha, ha, — qeshi me të madhe fantazma. — S'ke ku shkon, Liza Prena. Si? Nuk më njeh?

Ajo s'arriti të përbledhë veten, kur para saj dolën edhe katër burra të armatosur.

U tmerua, por sytë i shkrepëtinë.

— S'kini turp! Pesë burra i zini pritë një femre!

— Mos u ngut, moj vashë e mirë. S'kërkoj-më gjë të madhe prej teje. Vetëm dokumentin që more sot. Ja, kaq.

Ajo buzëqeshi egër. Gjaku iu ndez. Ndjeu-nevojen të bënte diçka; t'i vërsulej ndonjërit, t'i rrëmbente armën, ose...

Çfarë të bënte?!

— Folë, ty të presim! — e ai i tregoi revolen;

— Do na e japësh me të mirë?

Liza i rrrotulloi sytë në errësirë. E pa veten shumë ngushtë. Si mbetej gjë tjetër veçse të thërriste. Shtëpia nuk ishte shumë larg dhenëna, pa tjetër, do ta dëgjonte, e kushedi.

— Ti një fjalë e ne gojës, — tha njeri, sikur ta kish kuptuar mendimin e saj.

— Do flasësh apo jo?

S'kish më dyshim. Ata ishin diversantë. Liza u vërsul drejt të parit, e i përplasi dorën në trungun e një peme. Revolja ra. Por ajo s'arriti ta merrte.

Të tjerët i vunë pushkën në kraharor.

— Si thua?

Ajo buzëqeshi hidhur.

— Pritni! — tha ngadalë. Ja tashti.

Ju kujtuq se si, 5 orë më parë, kish zgjatur dorën e kish shtrenguar fort me të dokumentin e partisë.

— Të jesh bijë besnike e Partisë sonë, Liza, ndërtonjëse aktive e socializmit... i tha sekretari i Partisë, kur i zgjati tesrën.

— Premtoj, shoku sekretar, do jem bijë e denjë...

Buzëqeshën shokët, buzëqeshën thellë nga zemra.

Pastaj kur kish filluar shiu... Leka...

Liza preku ngadalë llërën, aty ku e kish kapur. Leka, pastaj e lëvizi dorën më lart, pafër zemrës, sikur donte të mbronte me të dokumentin.

— Hë, folë, se ta morëm shpirtin!...

— Tashti, ja...

Buzëqeshi sërish egër e thirri me zë të lartë:

— Dëgjoni pra... Të rrojë Partia.

Plumbat pëershkuan dorën që mbronte testrën e pastaj gjoksin e vajzës.

Gruaja, që klithi të shtëpia pranë, vrapi si hie e zezë. Kandilin ja shoi era, por ajo s'endali vrapi e lemeritur. Vrapuan edhe fshatarë të tjerë. Dikush mbante një fener në dorë. Dhe u duk qartë fytyra e bukur e Lizës, sytë e zes, që s'ishin myllur dhe buzët gjysmë të hapura.

E panë të gjithë dorën e gjakosur mbërthyer te gjoksi, e s'vunë re dorën e Lekës nga dridhei feneri.

## TRENDAFILI I EGER

Erdhët?

Plaka Drage lëshoi dërrasën që mbante në dorë dhe u doli përpara vajzave, që vinin të heshtura.

— Erdhët?

Por askush prej tyre nuk iu përgjegj.

Dhe plaka heshti. I shikoi vashat një nga një me keqardhje e me qortim. U kollit një herë, u kollit përsëri, priti, por ato s'e ngritën kokën dhe s'panë si i shkëlqyen sytë asaj, veçse dëgjuan fjalët e rrepta që tha.

— Po, po... S'flas kot. Të isha e re si ju, mu në quell do kisha fluturuar dhe fundja një trëndafil të egër do ta kisha prurë.

— Nënë Drage, ku s'kërkua... — tha më e vogla. Ne jemi gati të shkojmë kudo. Na thuaj, nënë Drage, ku të kërkojmë? Ne jemi gati...

Plaka u kollit dhe vështrimin e treti diku larg në horizont. Flokët e thinjur ia mori éra.

— Sikur të isha e re!.. Dhe duart do t'i kisha dietur edhe svtë do t'i kisha humbur, edhe jetën do ta kisha falur. Një jetë njeriu është kjo. Ndërsa atie presin qindra njerëz që duhen shëruar...

Foli plaka Drage, dëgjuan vashat. Dëgjoi edhe Mara e bukur e Lumirasit, dëgjoi dhe ndjeu një brengë, diçka të quditëshme që i shtërgoi kraharorin, i zuri fytin e desh i mori fryshtë.

«Po të ishte e re... E çfarë do të bënte nënë Drageja po të ishte e re, kur për rrëth ka vetëm gurë, gurë dhe plisa, ku gjelbërimi s'ka lënë asnje gjurmë? Çfarë do të bënte ajo?...» — mendonte Mara.

Gjithë natën s'vuri gjumë në sy.

«Si do t'a vente halli i tyre? Si do t'ja bënin? Luftëtarët prisin e, bashkë me ta, priste edhe Genci i saj. — Ky mendim e turbullonte.

Ku s'i vajti mendja asaj në errësirën e madhe të kësollës. Parafytyroi Gencin të gjakosur me qepalla të mbërthyera fort. Ai nuk fliste, vetëm merrte fryshtë me vështirësi. Plaga në gjoks i kullonte gjak. Kurse ilaq prej trëndafili të egër nuk kishte.

Ajo u tmerua nga ky parafytyrim; pastaj u ngrit nga vendi ku ishte dhe u struk pranë nënës së saj. I mbylli sytë fort, filloi të numërojë, por mëndja përsëri i fluturonte larg.

«Sa e marrë që jam. E pse mendoj për keq?... Genci është mirë, Genci është shëndoшë... Ku ka shpatë që të prekë trupin e tij?... — u mundua ajo të qetësonte veten.

I rrotulloi sytë në errësirë, sikur shpresonte ta gjente aty Gencin dhe buzëqeshi. Por s'kaluan as dy - tre minuta dha, mendimet, e

errëta e pushtuan përsëri. Këtë radhë iu duk vetja në fund të greminës, bërë copë-copë.

Kur filloi të agojë, Mara u ngrit dne u drejtua te sheshi para shtëpisë së nënë Drages; priti aty sa u mblodhën edhe shoqet, e tjetra; pastaj u nis bashkë me to.

— Nga të vemi? — pyeti njëra.

Të tjerat heshtën. Vazhduan: të ecin nga-dalë dhe plot shqetësim.

Vërtet, nga të shkonin? Bregut të lumit apo t'i ngjiteshin bjeshkës? Dimri i egër kisn tharë gjithçka. Gjëkundi s'kish mbetur asnjë gonçe trëndafili të egër, që duhej më shume se çdo gjë. Me lëngun e tij nënë Drageja, pre-gatiste një ilaç të mrekullueshmë. Fshati, në të cilën ato banonin ishte i vogël dhe kodrat që e rrëthonin s'ishin të mëdha. Ato të gjitha së bashku mund t'i kaloje brenda një dite, kurse matanë kodrave ishte e pamundur të kapërceje. Aty zhvillohej luftë e përgjakësh-me. Por, sidooftë, duhej kërkuar; duhej kërkuar çdo ditë.

— Unë them që secila nga ne të marrë një drejtim. Kështu s'do të na shpëtojë asnjë skut pa parë, — tha më e vogla. Vajzat u ndalën. E pranuan mendimin e saj; u zunë dorë përdore, qëndruan në formë rrëthi, pastaj i kthyen kurrizin njëra tjetrës dhe u nisen.

Marës i ra bregu i lumit. Ajo zbriti e heshtur poshtë bjeshkës.

«Atë ditë nënë Drageja do përgatiste lëngun nga trëndafili i fundit dhe çdo plaqë, që do të lyhej me të, do të shërohej» mendonte Mara.

Por befas u ndal nē vënd. Vështroi me përmallim një gur buz lumi. E preku me dorë pastaj shikoi lumin. Një mjegull e lehtë zvaritej mbi të, me ngadalë. Mara psherëtiu e rrënqeth e tëra.

«Si atëhere!... Tamam si atëhere? — bëbezoi ajo ngadalë. — Vëtëm se atëhere bjeshka gjelbëronte, gjethet e plepit pranë guđuliseshin mbi kokat tonë dhe ca re të bardha, të lehta në qielin kaltërosh, vraponin drejt malit.

Atëhere..

Një vit e ca më parë Mara kish qenë bresha më e bukur dhe më trime e Lumirës. S'kishte frikë nga asgjë, i shëtiste dhëntë e saj në çdo anë. Nië ditë mbrithi deri në këtë vend. U ul në lëndinën pranë, thuri çorape dhe pastaj vrapij bjeshkës për të mbledhur lule. Kur po këpuste nië manushaqe, dikush i preku gërshtet e gjatë. U ngrit rrëmbimthi, sytë i shkrepëtinë, u bë gati t'i vërtitej, por kur u kthyep rava, e ndjeu veten të pafuqishme përpara vështrimit të djalit, që i rrinte pranë dhe buzëqeshte.

— U trëmbë, Marë?..

— ...

— Pse s'flet?..

Ajo buzëgeshi dhe dy xixëllonja u ndezën në sytë e zes.

— Unë s'kam frikë as nga ujqërit, o Genc e jo të kem frikë nga nië njeri.

Zbritën të dy bjeshkës, pa thënë asnje fjalë; u ulën; ajo mbi një gur, ai më poshtë.

— Tri ditë kam që të kërkoj.

Ajo s'u përgjegj. I uli sytë dhe qerpikët formuan një hie të dëndur rrëth tyre. Pastaj vështrimin e hodhi mbi lumen.

— Shiko si zvaritet mjegulla, — tha me zë të ulet.

Ai e pa, po nuk foli. Ajo hodhi vështrimin mbi Oralin plak.

— Shiko, Genc, si nxin. Përse s'kâ asnjë gjelbërim ky mal?

— Ke frikë?

— Jo, unë s'kam frikë, veç jam kureshtare.

— Thonë se dikur brënda tij u ndez një zjarr i madh që pushtoi tërë malin. Kûr u shua zjarri, mali u bë shkrumb, i zi sterre; pas disa vjetesh ai u mbulua me gjëmba dhe ferra të pakalueshme.

Ajo dëgjoi me vështrimin e tretur të shkëmbinjtë e errët; dëgjoi plot mendime. Befas briti.

— Genc, Genc, shiko aty se ç'zbardhon, aty në rrëzën e Oralit!

Ai ti ngrif, shikoi me kujdes dhe u hodh në lumen plot zhurmë.

— Mos, mos, do mbyfesh! Mos, — i thirri Mara.

Por ai s'dëgjoi. I buzëqeshi asaj që nga bregu tjeter e vrapi te tufa ë lulevë që zbardhët nën këmbët e Oralit. Këputi vëtëm një dhe u kthyte i lumtur, i qeshur.

Mara nuk u besoi syve.

— Lule bore?..

I qeshi fytyra, i rrahu zëmra fort,

«Lule bore!...» Ai patjetër do t'ja jepte asaj  
dhe po t'ja jepte do té thosh se i falte zemrën.

Kështu e kishin zakon ata.

Ndaj kur zgjati dorën Genci dhe ja vuri  
në kokë, ajo u skuq e tëra.

Ai e vështroi me admirim, për një kohë të  
gjatë, pa thënë asnjë fjalë; pastaj bëlbëzoi:

— Sa nur të dha, o Marë!

Ajo nuk foli. Priti të dëgjonte akoma, pri-  
ti e qeshur, e lumtur. Dhe ai vazhdoi.

— E pranon, o Marë?..

Sytë e saj të zes vezulluan.

— O Genc! — Nuk foli më.

Sa mbriti në shtëpi e yuri lulen në një  
vazo dhe i shërbueu asaj sa mundi që të mos  
thahej, që të mos vyshkej.

2

Rinte Mara mbi gurin e bardhë dhe pshe-  
rëtinte; ndjente erën ta ledhatonte, shihte lu-  
min, që ikte rrëmbimthi, lumen zhurmëplotë.

— Pse qan? — e pyeti rrjedha e lumbit.

— Pse qaj? Për trëndafilat e egër që mba-  
ruan e nuk gjenden askund, Me se do të shë-  
rohen plagët e luftëtarëve? Trëndafila nuk ka  
më.

Heshti Mara, heshti dhe rrjedha. Por kur  
u ngrit ajo nga guri dhe mori rrugën nga e  
majta, ndjeu një zë.

— Dëgjo këtu!

Ngriu në vend dhe u mundua mos t'i shpëtonte asnjë fjalë e valës zhurmëmadhe.

— Në mes të asaj rrëpire të Oralit lulëzon një trëndafil i egër, një trëndafil i bardhë, i bukur. Po të mbjellësh një fletë të tij mbiijnë mijëra trëndafila të rinj... por...

Mara e dëgjoi lumin deri në fund. Nuk u trëmb nga fjalët e tij, hodhi vështrimin lart mbi Oral dhe iu çfaq sikur mu në mës të tij zbardhonte diçka.

— Tani do të nisem, — tha me guxim. Dhe iu duk sikur Orali plak që nxinte, i rrëpëtë dhe hierëndë, tallej me të, duke qëndruar sipër lomit, që gurgullonte më rrëmbim nën hien e tij.

— Do të nisem! — përsëriti ajo dhe u hodhi në ujë.

Me krahët e lehta çau dallgët e doli në breg e niomur, me flokët të ngjitur mbi ballë e pas kokës.

Trupi iu bë mornica-mornica. — Sa ftohtë që është! — tha ngadalë e u mblodh e tëra. Donte të ulej mbi një gur e të thahej nën rrezet e diellit që sapo agonte, por se një forcë tietë e tërroi përparrë. Ngriti kokën sipër. Orali plak këtë radhë iu çfaq i tmershëm, i lartë dhe i mprehët si thikë.

— Jo, nuk trembam! Unë do ta marr trëndafilin!

Filloi të ngjitej ngadalë mbi rrëpirën të rë gurë të zes. Vënde-vënde gurët thërmoheshin dhe këmba shkiste në zbrasësirë, por ajo mbahej fort pas kaçubeve me gjëmbë, që i

përgjaknin duart. Dhe kështu, me duar të përgjakura është këmbëtë të cilitura prej gurëve të mprehtë, Mara u ngjit deri pranë një shkembi të lartë e të mprehtë, që i qëndronte përpara, si mur i pakalueshëm. Nga e djathta ishte një ferrë e madhe e pakapërcyeshme, kurse nga e majta binin copa guri të thërmuar që përplaseshin me zhurmë mbi valët e lumi.

Vendosi të marrë nga e djathta, por, sa bëri hapat e para, ndjeu se s'mund të lëvizte më tutje. Ferra i zuri fustanin dhe iu ngjit pas trupit. Atëhere ajo mbloodi gjithë fuqinë dhe bëri përpara. U përplas me kokë te një gur, dhe rrëshqiti tatëpjetë malit e ra në lumin e ftohtë. Për një çast nuk kuptoi asgjë, pastaj lëvizi me shpejtësi duart, këmbët dhe u gjënd prapë nën këmbët e viganit. Ndjeu trupin t'i dhimbte, ndjeu plagët t'i digjin, por shtëringoi dhëmbët, duke hedhur vështrimin mbi Oralin që nxinte.

— Mos kujton se më trëmbe? Unë do ta marr trëndafilin, do ta marr, dëgjon?

Këshkoi të gjente një rrugë më të mirë. I ra bregut rrëthi e rrötull deri sa doli në një shteg nga kujtoi sé mund të kalonte. Por, pa bërë as gjysmën e rruges, befas rrëshqiti përséri dhe i mbërthëu duart degës sé fortë të një kaçube.

— ‘Oh, do të bijë!.. Do të vdes — thirri e tmeruar. — Dhe atëhere askush s’do ta marrë vesh të fshehtën.

Buza iu drodh, sytë iu çakëritën, duart iu këputën. E ndjeu veten pa fuqi, të drobitur. U rrëngeth kur parafytyroi se për një sekond do

bëhej copë e çikë. Atëhëre u shtrëngua. Dhëm-bët i kërcitën, kurse grushtët e vogëla të gjakosura tërhoqën trupin lart mbi kaçube.

Për një kohë qëndroi ashtu pa lëvizur, me fytyrën për tokë, me sytë të mbyllur dhe gjén të hapur; pastaj u ngrit ngadalë, dhe, duke ndjerë trupin t'i dridhej, bëri lart. Për çudi të saj tashti rruga ishtë më e mirë dhe gjëmbat e ferrat ishin të pakta, porse pranë trëndafilit gurët qenë të mprehtë dhe ishin gati të thërmoheshin. Duhej goditur guri me gur, sa të dilte tabani i tyre i qëndrueshëm. Pastaj, duke u zvarritur, duke u gjakosur më tepër se më parë, ajo arriti të dega, ku lulëzonte një trëndafil i vetëm me dhjetra gjethë pranë. I shkëlqyen sytë. Zgjati dorën e gjakosur dhe e këputi. Iu duk sikur në atë çast Orali oshëtiu, por nuk iu tremb syri. Vrapoi dhe as vetë s'e kuptoi, si u gjënd në gjysmën e rrugës, pranë kaçubës nga dukej Lumira si në pëllëmbë të dorës.

Kur kapërceu lumin e vrapoi bjeshkës lart, ajo dalloj mjaft drita të ndezura që lëviznin nga të katër anët e kodrës; e kuptoi se po e kërkonin.

— Ej, ej, motra! — thirri, e ndjeu se zëri i ishte ngjirur.

— Ej, motra, — përsëriti dhe u ul pranë sheshit e drobitur, kur pa se dritat e ndezura i afroheshin asaj.

— Jam këtu! Këtu te sheshi!...

Nënë Drageja erdhi e para. Ajo klithi e tmerruar dhe mbylli sytë; s'donte t'u besonte.

— Marë, bija e nënës, ç'ka ndodhur?..

Vajzat plot zhurmë rrethuan Marën dhe ngrinë në vend. Ndërsa Mara buzëqeshi ëmbël dhe tregoi trëndafilin që shkëlqente.

— Ah!... — klithi plaka, që filloj të shquante plagët që kishin filluar të hapeshin në trupin e vajzës. Vetëm ajo, midis gjithë atyre njerëzve, e dinte të fshehtën e tmershme të këtij trëndafili. Ajo dhe Mara, së cilës lumi i kish thënë, se do t'i hapeshin aq plagë, sa do të mbylleshin prej trëndafilit të këputur dhe, ndërsa mijëra luftëtarë do të shëroheshin, ajo do të lëngonte e do të lebetitej prej dhimbjeve gjersa të jepte shpirt.

Prandaj plaka shihte e tmeruar dhe kujtonte se Mara, që buzëqeshtë e lumtur, nuk e dinte të fshehtën e tmershme, mynxyrën që e priste.

— Nuk e ka qenë që do t'i kujtonte se Mara, që buzëqeshtë e lumtur, nuk e dinte të fshehtën e tmershme, mynxyrën që e priste.

— Nuk e ka qenë që do t'i kujtonte se Mara, që buzëqeshtë e lumtur, nuk e dinte të fshehtën e tmershme, mynxyrën që e priste.

— Nuk e ka qenë që do t'i kujtonte se Mara, që buzëqeshtë e lumtur, nuk e dinte të fshehtën e tmershme, mynxyrën që e priste.

— Nuk e ka qenë që do t'i kujtonte se Mara, që buzëqeshtë e lumtur, nuk e dinte të fshehtën e tmershme, mynxyrën që e priste.

## PAS PROVIMIT TË FIZIKËS

**A**groni nuk u ngrit atë mëngjes. I tha s'ëmës se nuk e ndjente veten mirë, i dhimbte koka, i merreshin mëntë, ndaj nuk do të shkonte në shkollë; kaq i tha, dhe u këthyen në krahun tjetër. Shikoi nga dritarja dhe e fshehu vështrimin midis fletëve të shëlgut, që përkundeshin lehtë.

Tefta i preku ballin me dorë të dredhur dhe, ndërsa i provonte pulsin, i tha të shkonte të mjeku!

Ai s'u përgjegj; s'lëvizi fare. Vështronte e vështronte nga shelgu. Kurse ajo priste e tronditur. Ç'të kishte vallë? Kish candidë që ish bërë tjetër njeri; s'ishte më Agroni i shkujdesur, që kthehej nga shkolla duke vërvhellyer apo duke kënduar, që thërriste nga koridori: «Mami, vdiqa për të ngrënë.»

Derën e hapte pa zhurmë, mezi shqiptonte «mirë dita» e s'fliste fare për shokët, pas për orët e mësimit; rrinte te dritarja duke i soditur rrugën, qellin... merrte ndonjë libër në dorë, por pendohej dhe e përplaste më ndonjë cep; dhe mësimet i prepatiste shpejt, e shpejt. Qëllonte që ta thërriste për të lojtur ndonjë shok, por ai i lutej nënës që t'i thosh se s'ishte në shtëpi.

— Ta gënjej? — e qërtonte ajo.

— Thuaji, ahëre, se s'dua të loz — i përgjigjej.

— Po pse? Ç'ke? Thuaji mamit — e luste Tefta. Kurse ai heshtëtë; heshtëtë ose përgjigjej thatë: — Asgjë, moj mami. S'dua të loz. Ulte sytë për të mos takuar vështrimin e syve të saj të zes, plot lbt.

Ajo s'e përbajti dot veten; u ul në gjunjë pranë krevatit; e përkëdheli lehtë, pastaj me zë të drithëruar e të dhëmbshur tha:

— Agron... pse më mundon? ... Më thuaj ç'ke.

— Ai u kthyesh nga nëna; i buzëqeshi me ngurrim:

— Ndöshta do të më kalojë, moj mami, — shqiptoi fare ngadalë.

— Kushëdi, s'kam gjë. Mundet që dhe të jem lodhur. Për... më lerë vetëm, dua të tie.

Tefta, e heshtur, mbylli derën, fare nga dalë, pa shkaktuar asnjë zhurmë. Për një kohë të gjatë qëndroi si e ngirirë prarië tryezës së kuzinës më mendime të zymta. «Jo, duhet thirrur doktori. Ai s'është mirë; éshtë zverdhur i terti. Duhet shpejtuar» — mërmëriti me vehte.

Kur u rrötullua, dy herë gelësi dhe zhurma e këpucëve me taka u shua. Agroni u ngrit, iu afroa dritäres dhe që pas perdes së tylit e ndoqi me sy nériën që ekte më të shpejtë. Si u bind se ajo ishte mjift larg e s'kish si kthehej shpejt, mori një lapës nga sirtari i komodinës; Vështrroi mirë e mirë vendin përqark, hypi mbi një karrige, e shehoi një pikë në murin perballë. Pastaj moti fuqi, vrapi dhe u hodh përpjetë për të kapur pikën e shenuar, por menjëherë u mbështet te muri dhe i kafshoi buzët fort se i sëmboi shumë këmba e majtë, kur takoi në dy sheme. Si i kaloi dhëmbja, filloj përsëri të hi-

dhej, të vraponte nëpër dhomë duke u përpjekur të prekte tavanin me dorë. Por kur i lëndohej këmba rëndë, ndjente një dhëmbje të hidhur. Trupi i bëhej miza, miza, sytë i lotonin. Si i mundur, ulej të krevati, shtrëngohen i terti e pastaj vështronte kuturu. Pikerisht në këtë gjëndje e gjeti nëna.

«Të mos jetë në vete? Mos ka temperaturë dhe unë s'e kuptova?»

Sytë e nënës u zgjeruan nga habia, kurse ai qëndroi i qetë, kokëulur.

— Çfarë ke, Goni?

Ai shtyu jorganin, u shtri në krevat, u mbulua dhe mbylli sytë.

Një dyshim që posa i lindi e ngrohu Teften menjëherë, e ngrohu sa për një çast, se pastaj, kur mendoi më mirë, u lëndua tepër.

— Çfarë ke, bir i mëmës?

— Ti s'je i vogël, Agron. Më thuaj çfarë ke. Pse më torturon këshfu?

— Asgjë, mami. Më dhëmb. . .

Nuk e mbaroi fjalën. Pa se si e mbushën me lotë sytë e nënës dhe u prek.

— Unë s'kam asgjë, moj mami.. Ja, do... aë tashti po vishem e po shkoj në shkollë.

Ajo mori një pecetë aty pranë dhe fshiu fytyrën; pshëreti thellë dhe, si u bind që djali s'vuante nga ndonjë sëmundje, doli nga dhoma.

Agroni s'ja shqiti sytë derës, kurse Tefta pranë drithares së kuzinës u shkreh në vaj. Tashti ajo e dinte shumë mirë përse ishte bengosur Agroni; e dinte pse vuante dhe u hidhërua pa masë.

«Si do t'ja bënte? Si do të vepronë?..»

— Nga dhoma pranë s'dëgjohej as zhurma më e vogël, sikur aty të mos kish njeri. Ajo vëndosi mos tâ shqetësonë më të birin. Vetëm pas dy orëve, kur u gjend pranë tij, buzëqeshi. Ai po lexonte:

— Si je, bir?..

— S'kam gjë, mami.

— Më trembe shumë, Agron... M'u duke aq i zbehtë. Thashë se të kish zënë të verdhët. Ti ke dhe një zakon të keq, s'tregon se ku të dhemb. Por jo... — vazhdoi ajo dhe i lëmoi dorën. — Tashti ti qënke më mirë. Apo jo?..

## II

Kjo històri nisi në një ditë vjeshte. Sapodra zilja e orës së pestë fëmijët, duke shtyrë njëri tietrin, dolën në oborr, pastaj në rrugën e asfaltuar dhë pak të njomur nga një vesë e lehtë shiu, që kishte rënë disa minuta më parë. Disa gjethë të verdha mbi trotuar akoma vezullonin nga pikat e ujtit.

— Mos i shkel! — thirri Agroni.

Berti, një shkollë i klasës, u tremb aq shumë nga britma e tij, sa që për pak, ra në një gropë më ujë.

— E pse? shfryu ky — Të vjen keq?

E veshtroi me tallje shokun dhë i vuri këmbën gjethes.

— Gjynah... — bëlbëzoi Agroni. — Kish një ngjyrë të bukur ajo gjethë. Për herë të parë e shoh. Dhe pikat sikur i jepnin shkëlqim.

Tjetri nuk foli. Ai u kënaq që veproi kundër dëshirës së Agronit, dhë, që ta përforconte

këtë, u propozoi shokëve të tjerë të pranonin kush do të arrinte i pari të shkundëtë pemët dhe të shkaktonte «shi artificial», si i thoshin ata.

— E pse të lagemi kot? Edhe pemët dëmtohen — ja preu Agroni.

— Do vini?

Berti fugoi i pari. Pas tij rendën dhe të tjerët, duke qeshur e duke thirrur. Për një çast edhe Agroni u mat të zgjaste radhën e vraponjësve, por shpejt u pendua.

Psherëtiu thellë, kur mendoi se s'kish mundësi të bashkonte zërin e tij me britmat e të qeshurat e fëmijëve.

E si do të fugonte ai?.. Ai ishte i çalë, këmbën e mëngjér e tërhoqte pak zvarrë nga një paralizim që kish pësuar kur kish qënë dy vjec.

Dikush prej fëmijëve, që vraponin, e vuri re Agronin e pikëlluar që kish mbetur larg tyre.

— Qëndroni — u thirri ai shokëve. — S'ka lezet. E lamë vetëm Agronin. Ai s'fugon dot.

— Prandaj s'desh të shkundëtë pemët — thirri Berti plot gaz. — Dhe na hiqet si më i miri.

— Pusho.

Agroni që së largu e kuptoi se bisëda sillej rreth tij. I shkoi në mënd se ata mund të ishin ndalur pikërisht për të, nga që s'fugonte dot dhe do t'u kish ardhur keq. D.m.th. ai qenkish fatke!

U afroa pranë shokëve, duke kenduar në-për dhëmbë një melodi të njojur. Nuk e dha veten fare, veç kur vuri re së largu Bertin, që hidhej e përdridhej dhe u thërriste Nazos, Lulit e të tjerëve, ndjeu një sërbim në krahëror.

Vazhdoi rrugën bashkë me të tjerët. Por, heshtja e shokëve sikur e vrau shumë. Dhe Nazua që pas pak belbëzoi: «Agron, a lozim shah mbas-dite?» e bëri atë të zverdhej në fytyrë e mezi të mbahej në këmbë.

«Të lozë shah... Vetëm për këtë është i aftë ai.... Të rrijë ulur në karrigë e të lozë... Të lëvizë pareshtur gurët... Të mendojë e pastaj të thérresë: shah! Dhe asnjë herë s'do të hidhet për të kapur degën më të lartë të pemës, asnjë herë s'do të ngjitet mbi shelgun te dritarja, s'do të vrapojë pas fëmijëve zhurmëplotë.»

— E pse të mbyllemi brenda — shqiptoi me gjysmë zëri.

Shokët heshtën. Nazua kafshoi buzën; e kuptoi se e kishte lënduar shokun dhe s'dinte ç'të bënte.

— Ama, edhe ajo fizika q'na e punoi, — vazhdoi ai muhabetin. — Do t'i vete me pesh-qesh mëmës.

Agroni nuk u përgjegj. Para disa minutash edhe ai kish menduar për provimin e fizikës. E kish gjuar ky provim se kishte marrë notën 10.. Kur të shkonte në shtëpi do t'i thoshte mëmës se kish zgjidhur problemin më të vështirë. Dhe ajo do të gjëzohej; do ta puthte... Do t'i thoshte mëmës... Por, jo... Tashti ai nuk do t'ja thotë. Ju duk i kotë ky gjërim.

### III

Kur iente profesoresha e fizikës përfundimet e provimeve me shkrim, Berti s'u besoi veshëve. Ai të kish marrë katër? E pamundur...

Ndaj rrëmbeu fletën e digka filloj të dërdëllisë. Agroni, që rrinte pas tij, i kërkoi provimin e, si i hodhi një sy fletës, me kutija katrone, i tha se nuk e kishte zgjidhur drejt, prandaj s'duhej të bënte fjalët.

— Mos na shit shumë mënd, — ja ktheu Berti dhe i rrëmbeu fletën. — Mori 10 ky dha se c'i duket vetja. E çfarë?

Ndaj, kur dolën në oborr, Berti po pëlciste nga dëshira për ta inatosur shokun, për t'i shikatuar pakënaqësi.

Por kjo dëshirë nuk zgjati shumë, najo shua menjëherë. Atë çast kur Agroni, kokëullur e i zymtë, u kthye në rrugicën e tij, Berti, që ishte shumë përpara shokëve, kish zemë vënd disa hapa larg portës së Agronit, i vëndosur që ta zemëronte më shumë, opor, kur pa fytyrën e tij aq të brengosur, kur pa sytë, tij që vështronin asfaltin, ku kalonë, i erdhur turp. Iu duk se Agroni i thembet vështrimit tallës të tij e shpejtonte të hynte në oborr.

— Agron... Agron... — zëri i dol i thate, i gjerrë. Dera e madhe kërciti fort. Përgjegje s'pati.

Pas ditë atij i erdhur turp të trokiste të ajo derë. Akoma e kish në vesh krismën e saj, që e tufballonte. Po si të bënte? Të shkonte t'i thoshtë më fal... Kjo ishte e pamundur; kjo do ta vriste shokun më shumë.

Prandaj gjithë atë ditë Berti e kaloi i ngrysur. Edhe kur ra të flejë, edhe kur u ngrit të nesërmén në mëngjes, e ndjeu vjetra të drobitur.

Si të vepronte tanë? Agroni vate shumë vanë në shkollë; u ul në bankë një minutë para profesorit dhe s'i dhë rast Berti që të bisedonin.

Në pushimin e orës së dytë Berti i kërkoi flstroytoren e detyra. Vetëm sa ta shikonte. I kishin nxjerrë një lloj përfundimet? Në pushimin e madh ai e zuri për krahu Agronin dhe e pyeti për diçka që nuk kish kuptuar në mësimin e kimisë. Agroni ja shpjegoi, por bisedën nuk ja zgjati, dhe s'mori pjesën në gazin e përgjithshëm, kur dikush, fare pranë tij, tregoi diçka qesharake.

— Ditën e tretë, kur Agroni s'erdhi fare në shkollë, Berti, më tepër se kushdo në klasë, e ndjeu mungesën e tij.

— C'të ketë? — pyeste shokët.

— Mos e ka zënë gripi — përgjigjej ndokush.

Por ai s'u besoi këtyre fjalëve. Në pushimin e madh vrapi deri te shtëpia e Agronit, pyeti Teftën, që ishte duke larë në oborr dhe, si mësoi se ai kishte pak temperaturë, u' zhduk, në rrugicën nga kish ardhur. Tani e ndjente veten më të lehtësuar. Agroni ishte sëmurë dhe Berti s'kish gisht në këtë mës.

Pasdite ai, Nazua e Genci ndejtën nja dy orë te Agroni, dëgjuan në radio lojën e fotballit, e kur u larguan, ndërsa Nazua dhe Genci beshnin me të madhe, ai rrinte i heshtur se Agroni nuk vështroi asnje herë nga ana e tij; edhe kur i zgjati dorën ky, s'ja hodhi sytë. I zuri lehtë majat e gishtérinjve, ndërsa fliste me Nazon.

Dhe kjo ia përforcoi Bertit mendimin se kishte bërë fai të madh, një gabim të pandreqshëm. Ndai, të nesërmëni, kur foli mësuesja e fizikës, ndërmjet të tjerave, për Agronin, ai u shkuq. Mos vallë edhe këto fjalë thuheshin si dë-

nim për të? Mos vallë nëna e Agronit, e cila para dy orëve ishte në shkollë, dinte gjithçka dhe ja kish treguar mësueses?

Nuk e dëgjoi mësimin. Në pushimin e madh u trondit së tepërmë, kur atë, Gencin, Nazon dhe dy nxënës të tjerë i mbajti mësuesja e fizi-kës, që ishte edhe kujdestare e klasës.

— Me ju do të flas hapur — u tha ajo — se dua të na ndihmoni. Ju jeni shokët e Agronit dhe nxënësit më të mirë të klasës. Ka disa ditë që Agroni ka ndryshuar shumë. Si duket, dikush do ta ketë fyter dhe ai është pre-kur mjaf. Dini gjë ju? Me kë është zënë? Çfarë i kanë thënë? Ne duhet të dimë gjithçka që, pastaj, ta fillojmë punën. Agroni ka ndryshuar shumë.

— Po... — belbëzoi Genci.

Mësuesja priti, por askush nuk foli. Berti vështroi koshin e kartërave, mbushur plot, aty, jaشتë klasës.

— Domëthënë s'më ndihmoni dot? — pyeti mësuesja. — Sidoqoftë... ju jeni të rritur tanë, jeni në klasë të gjashtë... duhet të mendoni se si ta tërhiqni Agronin e ta ndihmoni. Si duket, ai preket shpejt.

Nxënësit u shpërndanë, kurse Berti s'leviz nga vëndi.

— Zonjushë... — shqiptoi më zë të ulët. — Dhe sakaq një të kuq të lehtë i mbuloi fytyrën.

— Çfarë ke, Berti? — Mësuesja mbeti si e gozhduar pranë derës.

— Zonjushë... unë...

Dhe i tregoi kokëulur historinë e gjethes, të shiut artificial. historinë se si hidhej e qeshjet në

magën e asfaltuar dhe s'pa si u theluan më te për sytë e kaltër të zonjushes, si ajo i ngrysi vetyllet hark, si e treti vështrimin tej dritares për të gjetur ndoshta zgjadhjen më të drejtë.

— Ti do ta lash këtë faj, Berti. Mos qaj. Unë e shoh që ti do ta lash — tha me gjysmë zëri. E, pas një heshtjeje të vogël, vazhdoi:

— Qysh sot do të shkosh bashkë me shokët dhe do t'i thuash...

Berti u zverdh.

— Jo, zonjushë.

— Prit, Berti. — Sigurisht s'do të t'i flasesh për fajin tënd; do t'i tregosh të gjitha fjalët që thashë unë në orën e fizikës. Ti je djale i zgjuar, besoi se do t'ja dalësh.

#### IV

Kur hapën derën e dhomës së Agronit, Berti e Nazua, ai s'lëvizit fare, kur jo se do të ishte ndonjë nga të shtëpisë. Ishte përqëndruam i téri në një motor maqine, fare të vogël. Dicka lëvizte aty me një pincë.

Ata nuk i folën. U ulën në kamiga dhe pritën që ai të ngrinte kokën.

— Oh, qenkeni ju, — ja bëri Agroni dhe e ja motorin e prishur.

— Mbao punë! Ne s'të pengojmë, biles duam të shohim a do ta rregullosh dot, — i tha Nazua.

— Më mungon një tell i hollë. Mëma s'ka. Ta provoj një herë me pe.

— Tel? Më duket se kam unë në shtëpi! Më mrit. Për pesë minuta vij — tha Berti dhe u

zhduku aty pér aty. Agroni nuk foli. Atë e habiti kjo gadishméri e Bertit.

Mori maqinën, e kuqe, një lodër të motrës së tij, që e kishin blerë para dhjetë ditëve, e shikoi me kujdes dhe u bind se, po të kish telin, do ta rregullonte menjëherë.

Berti u kthye shpejt nëllë e zotit.

— S'i tha koi zonjushja gjithë ato fjalë pér ty, — e ngacmei Agronim, — që vëllai i kishte.

— Ç'fjalë?

— Ku mbahen mënd. Në fillim i erdhë keq që s'ishe në mësim. Na dha një problem të vesh-tirë. Askush s'e ngriti dorën dhe ajo u imatos! «Po të ishte Agroni, — tha, — do ta kishter zgjidhur; ai jau hedh të gjithëve që sikur të vazhdojë ta mësojë fizikën po me këtë zell që ka e të tregojë do këtë interes dhe më vonë gjatë praktikës, do bëhet fizikant i zotit.»

Agroni qeshi dhe pér të parën herë e shikoi rrëmbimthi Bertit.

— S'të gënjej, Goni... Ja, pyet Nazen.

— E po ajo pérherë e thotë këtë, — tha Nazua si me përtimi. — A ka orë që mës të të lavdërojë ty? Po Agroni s'foli. Tefta u sollë nga një copë kek. Mori maqinëm, të cilën para pak kohë e kishi shkatërruar vetë, pér t'i gjetur një punë Agronit, dhe si e shikoi mirë, tha e gjëzuar.

— E shikoni që e rregullove? Sa do gjëzohet Vera kur të kthehet nga kopshti.

— Më tha një shok — tha Nazua — se rrethii i teknikës në pallatin e pionerit ka shpëllur konkurs pér një hidroplan. Ai që do ndertojë më të mirin, fiton konkursin dhe, më një

qershori hidroplanini tij do hidhet të lundrojë në ujërat e liqenit. Mendova të marrim pjesë edhe he. Kushedi, fitojmë. — Kot, — bëlbëzoi Agroni! — Pse kot?.. Po të tjerët ç'janë? — u hodh Berti.

— Kot... Ne s'kemi vajtur asnje herë në rrëthi. Si do t'ja arritmë pér gjashtë muai?

Agroni fliste, por këtë radhë s'e vështronte fare Bertin.

— Ohu! — ja bëri ky i fundit. — E provojmë një herë.

Teftës i shkëlqyen sytë.

«Sa mirë e mendoi Nazua. Si s'i kish shkuar në mënd!.. Pallati i pionerit... Kjo është e mrekullueshme» tha me vete.

Dhe ajo u përzie në muhabetin e tyre.

— Pse mos ta provoni, Goni? Gjashtë muaj nuk janë pak. Do mësoni e pò të jeni të zotë...

Berti e Nazua buzëqeshën; ndërsa Agroni s'lëvizi fare.

— Si thua?

— Shohim e bëjmë, — tha ai ngadalë. Në të njëjtën kohë ndjeu se e kapi një dëshirë e panjohur; ndjeu se i pëlqente të ndërtonte një hidroplan, një hidroplan që do të çante liqenin. Por nuk e shprehu këtë dëshirë. Nuk donte ta jepte veten përparrë Bertit.

Vetëm pas një muaji, kur tashmë ish bërë anëtar i irregullt i fëretit të teknikës e s'linte ditë pa shkuar atje, i tha s'ëmës:

— Sa është kam që hidroplani im të fitojë... Ti do të vish patjetër, ato jo. mami? Dhe do të më shikosh mua kur ta hedhi në ujë... Sa shumë njerëz do të janë... Si thua, mami?

Dhe buzëqeshi nga kjojëndër, kurse nëna e dëgjonte me mallëngjim. Tashti ajo ishte e lumtur. Agroni ish tërhequr aq shumë pas atij rrithi, sa që çdo bisedë do ta lidhë me profesionin e inxhenjerit, me shokët e tij teknikë.

— Ti mos u mërzit, — i thosh Teftës. — Do të kthehem shpejt! Më pëlqen shumë, e kupton? Si thua? Të bëhem inxhenjer aviacioni? — dhe e puthte fortuna.

Tefta buzëqeshte. — Vetëm të të shoh ty të qeshur, të lumtur.

— mendonte në ato çaste ajo.

Agroni zbriste shkallët, dilte në rrugë, shkonte pranë shtëpisë së Nazos e thërriste këtë e që të dy sëbashku niseshin përmë pallat.

— Thérresim edhe Bertin? — i thosh Nauza.

— Ai e ka larg shtëpinë, dhe vjen vetë — thoshte Agroni me të shpejtë, se akoma nuk e kish harruar hidhërimin që i kish shkaktuar Berti dikur. Biles i ish tiposur se ai nuk ja donte të mirët. Kot tregohej i afërt me të, i gatshëm, i papërtueshëm përmë gjë. Megjithëse Ndonjë herë Agroni e ndjente veten ngusht. Ai Berti sikur s'lavdërohej më para tij, sikur nuk e tregon, te më veten si më parë.

— Ti e ke bërë më mirë, — thoshte përherë.

Kushedi...

V

Qershori po afronte. Të gjithë anëtarët e rrithit të teknikës i kishin gati hidroplanët e tyre dhe prisnin komisionin që të vendoste.

— I yti do tē fitojë, — i theshi Berti. — Patjetër. Të gjithë ja kanë frikën.

Berti e ndjente shumë ndryshimin që kish pësuar Agroni në marrëdhëniet me tē, midaj mundohej ta kënaqte shokun, që ky tē mendonte ndryshtë, t'ja falte gabimin e t'i thosh: tē kam shok, Berti. Por çështë e vërteta, ai asgjë s'e bënte për hipokrizi, sa për t'i marrë mëndjen;

— Hajt, vemë bast po s'fitoi hidroplani yth — i përsëriste pa reshtur.

Dhe, me tē vërtetë, ashtu ndodhi. Hidroplani i Agronit u pëlqye shumë dhe u vendos që ai të hidhej për tē çarë ujérat e liqenit mië një qeshor, por se në mbrëmjen e 31 majit ndodhi diçka që fitonditit të gjithë. Një pionere i vogël, duke ikaluar përmes sallës u pengua e u përplas pas tavolinës ku ishte hidroplani. Ai ra poshtë. U thyelikë, një rrötë e diçka tjeter. Të gjithë vrapanutë vëndi i ngjarjes, të gjithë u alarmuan; s'diniq c'të bënin.

— Të caktojmë një hidroplani tjetër, — u dëgjuat një zë.

Agroni u zverdh. Ngrihi rrötën që i ish thyer dhe ndjeu se dorati dridhej. Edalloindhe Berti atë drithërimë e thirri me tē emadhe.

— Jo!

Por Agroni as që e ndëgjoi. U mundua tē mos e jepte veten e tē përbante lotët...

— Jo! — thirri përséri Berti.

«Kjo është e tmershme!.. Është e tmershme për' tē, — mendoi. Po çfarë tē bente?

— Jo, profesor, — iu afroa ai inxhenjerit.

— Kjo është...  
Nuk e mbaroi fjalën.

— Profesor, nè jemi gati tē punojmë gjithë

natën dhe ta rregullojmë hidroplanin e Agro-nit.

Lotët iu rrökullisën nëpër faqet e tij.

Profesori s'u përgjegj; ai e vështroi mirë e mirë hidroplanin e murmuriti:

— Do shumë punë.

— Po ne rrimë gjithë natën, profesor. Apo jo?

— Filloni nga puna, — thirri profesori. — Hajde, ti, Agron, merr elikën, Berti të marrë rrotën, kurse...

Agroni lëvizi si i shushatur; ai pa lotët në faqet e Bertit porse s'po kuptonte gjë.

— Hajde, Agron, — i thirri përsëri profesori.

— Çfarë?

— Do të punojmë gjithë natën. Na lejoi profesori. Do ta rregullojmë, — i tha Berti plot gaz, duke fshirë me dorë lotët, që i kishin mbetur në mes të faqes. Dhe, vetëm atëhere, Agroni e kuptoi përsë rrodhën ata lot. T'ja kish thënë dikush tjetër këtë ndodhi s'do ta besonte kurrrë. Por ja, që e pa me sy vëtë... Njerëzit janë të mirë! Sa të mirë janë njerëzit! Kurse ai vet. Agroni, ishte njeri me shpirt të vogël.

Ishte ora një pas mesnate, kur u rregullua hidroplani. Shokët, të gjuar, u larguan nga pallati, duke kënduar me zë të ulët.

## PËRMBAJTJA

	Page
Mos e këndo atë këngë .....	3
Zana .....	19
Një gabim .....	66
Trokitje në derë .....	75
Kur binte shi .....	90
Trëndafili i egër .....	97
Pas provimit të fizikës .....	107

Redaktor: Razi Brahim  
Korektor letrar: Ali Hasherva  
Kopertina: Pandi Mele  
Redaktor teknik: Adam Lita

Tirazhi: 2000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-55

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» - Tiranë 1965